



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



RAPORTI VJETOR 2012

Prishtinë
mars 2013

Vizioni

“Shërbime cilësore, dhe të qëndrueshme të ujësjellësit, kanalizimit për të gjithë qytetarët e Kosovës.”

Misioni

“Të bëjë Rregullimin e kompanive të ujësjellësit, kanalizimit në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore, efikase dhe të sigurta në përputhje me praktikat e mira Evropiane, veçanërisht duke u fokusuar në promovimin e efikasitetit, transparencës, shtrirjes së shërbimeve për të gjithë qytetarët, mbrojtjen e konsumatorëve, me çmime sa më të përballueshme për shërbimet e ofruara, gjithmonë duke pasur në konsideratë mjedisin dhe shëndetin publik.

Përmbajtja

PËRMBAJTJA.....	3
1. PARATHËNIE	5
2. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK	7
2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK	7
2.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUK.....	8
3. AKTIVITETET RREGULLATORE TË ZRRUK	9
3.1. LICENCIMI	9
3.2. PERFORMANCA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT	11
3.2.1 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME.....	12
3.2.1.1 MBULUESHMERIA ME SHËRBIME TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT	12
3.2.1.2 UJI I PRODHUAR, SHITJET DHE UJI I PAFATURUAR	13
3.2.1.3 FATURIMI DHE ARKËTIMI	14
3.2.2. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT	15
3.2.2.1 MBULUESHMERIA ME SHËRBIME TË UJËSJELLËSIT	15
3.2.2.2 MBULUESHMERIA ME SHËRBIME TË KANALIZIMIT	16
3.2.2.3 UJI I PAFATURUAR	16
3.2.2.4 PROPORCIONI I KONSUMATORËVE ME UJËMATËSA	17
3.2.2.5 SHKALLA E ARKËTIMIT	18
3.2.3. PERFORMANCA E NHE 'IBER LEPENCI'	19
3.3. TARIFAT E SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIM	19
3.3.1 TË DHËNAT FINANCIARE	20
3.3.1.1 PËRMBUSHJA E CAQEVE PËR SHPENZIMET OPERATIVE PËR UJË DHE UJËRA TË ZEZA	20
3.3.1.2 PËRMBUSHJA E CAQEVE TË FATURIMIT	20
3.3.1.3 PËRMBUSHJA E CAQEVE TË ARKËTIMIT	21
3.3.1.4 TË DHËNAT E SHKALLËS SË MBULUESHMERISË SË SHPENZIMEVE OPERATIVE TË DREJTPËRDREJTA NGA ARKËTIMI I REALIZUAR GJATË VITIT 2012	21
3.3.2. PËRMBUSHJA E CAQEVE PËR INVESTIMET KAPITALE.....	22
3.3.2.1. PËRMBUSHJA E CAQEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA TË FINANCUARA NGA BURIMET VETANAKE TË KOMPANIVE	22
3.3.2.2. PËRMBUSHJA E CAQEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA TË FINANCUARA NGA DONATORËT	23
3.3.2.3 PËRCAKTIMI I TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJIT PËR VITIN 2013.....	24
3.3.2.4. PROCEDURAT E ELIMINIMIT DHE STANDARDIZIMIT TË FATURIMIT TË PAUSHALLIT.....	27
3.3.2.5. PËRCAKTIMI I TARIFAVE PËR SHËRBIMET E MBETURINAVE TË NGURTA KOMUNALE 2012	28
3.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE	29
3.4.1. ZBATIMI I STANDARDEVE TË SHËRBIMIT.....	29
3.4.1.1 KUALITETI I UJIT.....	30
3.4.1.2 VENDOSJA E UJËMATËSVE	31
3.4.1.3 LEXIMI I UJËMATËSVE	31
3.4.1.4 SHQYRTIMI I NGARKESAVE PAUSHALLE PËR NJËSINË OPERATIVE VUSHTRI	31
3.4.1.5 TRAJTIMI I ANKESAVE TË KONSUMATORËVE	32
3.4.1.6 KËRKESAT PËR LIRIM NGA PËRMBUSHJA E STANDARDEVE TË SHËRBIMIT.....	32
3.4.1.7 AKTIVITETET TJERA	33
3.4.2. ROLI DHE AKTIVITETET E KOMISIONEVE KËSHILLUESE TË KONSUMATORËVE(KKK).....	33
3.4.2.1 AKTIVITETET E KKK.....	33

3.4.2.2	SHQYRTIMI I ANKESAVE	34
4.	AKTIVITETET NË KONSOLIDIMIN INSTITUCIONAL.....	36
4.2.	AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV	36
4.2.1.	AMANDAMENTIMI I LIGJIT NR.03/ L-086 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT 2004/49 MBI VEPRIMTARITË E OFRUESËVE TË SHËRBIMIT TË UJËSJELLËSIT, KANALIZIMIT DHE MBETURINAVE ("LIGJI NR. 03/L-086")	36
4.2.2.	AMANDAMENTIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR;.....	36
4.2.3.	AMANDAMENTIMI I LICENCAVE TË SHËRBIMIT.....	36
4.2.4.	KOMISIONI SHQYRTUES.....	37
4.2.5.	INICIMI I PROCEDURAVE GJYQËSORE	37
4.2.6.	SHQYRTIMI I KËRKESAVE PËR SHKYCJE KOLEKTIVE	38
4.2.7.	MBËSHTETJA INSTITUCIONALE NGA DONATORËT	38
5.	RELACIONET E JASHTME.....	39
5.1.	BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË.....	39
5.2.	BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EVROPË	40
5.3.	BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN	40
6.	ASPEKTET FINANCIARE.....	42
6.1.	SHPENZIMET.....	42
6.2.	MBËSHTETJA NGA DONATORËT	43
6.3.	TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2012	43
6.4.	ASETET E ZRRUK.....	43
7.	REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	44

1. Parathënie

Me kënaqësi jua paraqesë Raportin e Punës së Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim, për vitin 2012 (të pestin me radhë), i cili paraqet aktivitetet dhe arritjet kryesore të institucionit tonë, por edhe gjendjen aktuale të sektorit të Ujit në Kosovë.

Mundë të themi se ky ka qenë një vit ku fokusi i punës së ZRRUK, ka qenë i orientuar më tepër nga Konsumatorët, duke rezultuar me disa përfitime të mira për konsumatorët e shërbimeve të ujit në Kosovë.

Pas përmbylljes së procesit tre (3) vjeçar tarifar të viteve 2012-2014, aktiviteti i jonë kryesorë ka qenë implementimi i gjithë asaj që ishte planifikuar, për tu realizuar gjatë vitit të parë të vlefshmërisë së tarifave të vitit 2012.

ZRRUK nga monitorimi i performancës së arritur të KRU`ve gjatë vitit 2012 dhe obligimit të saj për rishikim të tarifave volumetrike të shërbimeve të ujit për vitin 2013, ka marr parasysh shumë e projekteve të investimeve kapitale, të realizuara në raport me caqet e përcaktuara me tarifat e vitit të kaluar për shtatë kompani (veç e veç), për të përcaktuar tarifat e këtij viti.

Tarifat e vitit 2013 janë indeksuar duke i fut në raport shkallën e investimeve kapitale të realizuara me lëvizjet infatore të Indeksit të Çmimit të Konsumit në Kosovë (IÇKK) publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), për periudhën tetor/2010 – dhjetor/2012.

Nga kjo mund të konkludohet se tarifat volumetrike të shërbimeve të ujit për vitin 2013 në nivel të sektorit për të dy grupimet e konsumatorëve; shtëpiakë dhe jo-shtëpiakë, janë ngritë për nga 0.02 €/m², shprehur në % kjo ngritje të konsumatorët shtëpiakë është 5.65%, ndërsa ato të konsumatorëve jo-shtëpiakë kanë pësuar një ngritje prej vetëm 2.16%.

Kjo ka rezultuar që tarifat për vitin 2013 të mos të ngritën sipas metodologjisë tarifore të përcaktuar të vitit 2011 për vitet 2012-2014, pasi kompanitë nuk i kanë realizuar projektet e investimeve kapitale të aprovuara nga ky rregullatorë të cilat në një formë janë të ndëshkuara.

Si rezultat përfundimtarë mund të thuhet se tarifat e vitit 2013 janë më të ulëta se ato të projektuar me politikat tarifore për vitet 2012-2014, dhe atë; (i) për konsumatorët shtëpiak tarifat e vitit 2013 në mesatare janë më të ulëta për 6,51%, ndërsa ato të konsumatorëve jo-shtëpiak janë më të ulëta për 6,22%.

Gjatë periudhës 2012 monitorimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit është bërë në përputhje me synimet strategjike të ZRRUK, të paraparë në 'Planin Strategjik 2012-2014'.

Në veçanti ZRRUK është angazhuar shumë që KRU-të të zbatojnë një faturim sa më të saktë dhe në vijë me këtë: **Së pari**, ka kërkuar nga Kompanitë që të gjithë konsumatorët e tyre të pajisen me Ujëmatës funksional. **Së dyti**, me qëllim të vlerësimit të rregullshmërisë të leximit të ujëmatësve nga ana e KRU, janë ndërmarr aktivitete të inspektimit të leximit të ujëmatësve, me ç'rast, janë identifikuar një përqindje e konsiderueshme e pa rregullsive me rastin e leximit të tyre dhe për këtë, ZRRUK ka gjobitur 3 KRU, tek të cilat janë identifikuar parregullsitë me të mëdha të leximit të ujëmatësve, si dhe **Së treti**, duke marrë parasysh se ende një përqindje e konsumatorëve janë duke u faturuar në mënyrë paushalle dhe duke parë se disa Kompani zbatojnë praktika të ndryshme dhe shpesh herë edhe tepër të larta, ZRRUK e ka parë të arsyeshëm që të ndërmer një pozicion sa më të drejt karshi kësaj praktike dhe ka aprovuar listat e ngarkesave të paushallit, së bashku me 'Procedurat Interne', të përpiluara konform udhëzimit për faturimin paushall, si dhe të aprovuara në kuadër të legjislacionit sekondar.

Edhe përkundër sfidave të shumta me të cilat aktualisht përballet sektori i shërbimeve të ujit në Kosovë, Performanca e përgjithshme e Sektorit, si dhe Performanca individuale e Kompanive në disa prej tregusëve të punës, ka shënuar disa përmirësime të rëndësishme.

Përqindja e konsumimit të matur është rritur deri në 91% në vitin 2012, përmirësimi është për 10% brenda vitit 2012, dhe kjo ka sinjalizuar se Kompanitë e kanë marrë seriozisht kërkesën e bërë nga Rregullatori, për ti vendosur ujëmatësit, si dhe për të siguruar një faturim sa më të saktë për të gjithë konsumatorët e tyre.

Në pajtim me Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i cili ka hy në fuqi më 08 qershor 2012, ZRRUK nuk do të rregullojë më aktivitetet e Ofruesve të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave. Në fakt me ligjin e ri janë paraparë që të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë institucionale të ZRRUK-it, në lidhje me këtë sektor, të barten te Qeveria e Kosovës dhe Pushteti Lokal. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Sektori i grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale plotësisht është de-rregulluar dhe i është nënështuar konkurrencës së tregut.

Duke u nisur nga ky fakt, ZRRUK ka marrë iniciativë për të propozuar iniciimin e procedurave për amandamentimin e Ligjit të ZRRUK Nr. 03/L-086. Komisioni Parlamentar për Bujqesi, Pylltari e Planifikim Hapsinor, ka miratuar nismën për hartimin e Projektligjit për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë, për të cilin shpresojmë se së shpejti edhe do të finalizohet.

Në Maj të vitit 2012 ka përfunduar projekti dy vjeçar në mbështetje institucionale për ZRRUK, i financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, të cilin e falënderojmë, e po ashtu shpreh respektin e plotë për implementuesin e këtij projekti, konsorciumin e udhëhequr nga IPA, për implementimin e suksesshëm të këtij projekti. Ne konsiderojmë se përkrahja përmes projekteve mbështetëse duhet dhe më tej të vazhdojë, sidomos është evidente nevoja e përkrahjes në fushën e implementimit të standardeve të shërbimit, si dhe në atë të trajtimit të ujërave të zeza, për të cilën kemi bërë edhe kërkesë tek Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), nga i cili kemi marrë premtime për fillimin e shpejt të tij.

Zyrtarisht nga data 18.12.2012, ZRRUK është anëtarësuar në Shoqatën Ndërkombëtare të Ujit (International Water Association (IWA), që është rrjeti kryesor i sektorit të ujit në botë.

Jam i bindur se ky Raport Vjetor do të jetë mjaft i dobishëm si në paraqitjen e punës së vazhdueshme të ZRRUK, në përmbushjen e funksioneve rregullatore, si dhe tregon një pasqyrim të situatës së sektorit në tërësi, duke përfshirë dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e politikave të nevojshme në këtë sektor.

Me këtë rast unë dua të falënderoj të gjithë stafin e Zyrës, institucionet dhe donatorët të cilët kanë kontribuar dhe mbështetur Institucionin tonë.



Raif Preteni
Drejtor i ZRRUK,

2. Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë e ZRRUK

2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUK

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK) është organ i pavarur rregullator, i cili bënë licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit në Kosovë, i themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me [Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49](#), në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me [Ligjin Nr. 03/L-086](#) të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 13 qershor 2008, duke transferuar raportimin e ZRRUK, nga UNMIK-u tek Kuvendi i Kosovës.

ZRRUK është autoritet i pavarur, që ka përgjegjësi rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, dhe kanalizimit.

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUK janë:

- **Përcaktimi i tarifave** që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve;
- **Dhënia e licencave** për ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit;
- **Mbrojtja e interesave të konsumatorëve**, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e monopolit dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit;
- **Monitorimi dhe raportimi i performancës** së ofruesve të shërbimeve;
- **Përcaktimi i procedurave dhe kushteve për shkycje** individuale dhe kolektive të konsumatorëve nga rrjeti i ujësjellësit;
- **Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve** dhe mbështetja e punës së tyre.

Pra, ZRRUK është përgjegjës për të siguruar se ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit në Kosovë, iu ofrojnë konsumatorëve shërbime efikente dhe cilësore me çmim të përballueshëm.

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta rregullatore, ZRRUK udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086, si dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorin e ujit. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është përcaktuar me legjislacionin sekondar (14 Rregullave) të nxjerrë nga ZRRUK në Janar të vitit 2005 dhe të Amandamentuara kohë pas kohe, edhe gjatë vitit 2012.

Me rastin e ndryshimit të Ligjit për Mbeturinat Nr. 04/L 060 neni 82 dhe 83 e ligjit, ZRRUK nuk është më kompetent për rregullimin e sektorit të mbeturinave.

Tani ZRRUK është përgjegjës për rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, që përfshihen edhe ujërat e zeza në përgjithësi.

Emërtimi i Rregullatorit deri në amendamentimin e Ligjit 03/086 do të jetë Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK), në pajtim me MAP-in.


2.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUK

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-086, ZRRUK udhëhiqet nga Drejtori dhe Zv. Drejtori, si persona përgjegjës për funksionimin e Zyrës, si dhe për marrjen e vendimeve rregullatore. Emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me mandat 5 vjeçar.

Me qëllim të operimit më eficient, efektiv dhe me kohë, ZRRUK ka aprovuar strukturën organizative të organizimit, sipas të cilës departamentet e ZRRUK i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUK-it.

ZRRUK përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: **Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullatore**, **Departamenti i Performancës dhe Departamenti për Ligj dhe Licenca**, ndërsa përgjegjës për mbështetjen e veprimtarisë rregullatore të ZRRUK-it është **Departamenti për Administratë dhe Financa**.

Struktura organizative e ZRRUK



3. Aktivitetet Rregullatore të ZRRUK

3.1. LICENCIMI

Në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086, ZRRUK, gjatë vitit raportues ka bërë ripërtirjen e licencës për kompanitë publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimeve dhe furnizimit të ujit me shumicë.

Për informimin e juaj më të plotë, po i paraqesim Kompanitë e Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Kompanitë për Furnizim të Ujit me Shumicë, në vitin 2012.

(i) Kompanitë e Licencuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe duke u bazuar në procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar, ZRRUK ka ripërtëri licencat për kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit si vijon:

1. **KRU “Prishtina” Sh. A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime, Graçanicë dhe Drenas ;
2. **KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë, Dragash dhe Mamush;
3. **KRU “Hidrodrini” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë dhe Junik;
4. **KRU “Mitrovica” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri;
5. **KRU “Radoniqi” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe Prizren;
6. **KRU “Hidromorava” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë dhe Viti;
7. **KRU “Bifurkacioni” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunën: Ferizaj .

Licencat e Shërbimit për Ofruesit e Shërbimeve për shërbimet e Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë janë ripërtirë në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve (01.11.2012 - 31.10.2015), nga arsyeja e mos qëndrueshmërisë financiare të Kompanive respektive dhe performansa jo shumë e mirë.

Licencat e shërbimit janë lëshuar me Kushte Plotësuese të cilat janë;

- i. Sigurimi i lejeve për nxjerrjen e ujit dhe lejet për shkarkim të ujërave të zeza,
- ii. Lidhja e Marrëveshjeve të Shërbimit me Komunitet, të cilat nuk kanë nënshkruar këtë Marrëveshje,
- iii. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare.

Këto kushte kanë mbështetje në legjislacionin aktual primar dhe sekondar.

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Shtërpçë, Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator që e zbaton ZRRUK.

Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-086, dhe në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/18, të datës 08.06.2011, me qëllim që Njësia Operative e Deçanit dhe Kaçanikut të kthehet në

menaxhimin e KRU “Hidrodrini”, respektivisht “Bifurkacioni”, kemi pasur shumë tentativa me të dy komunat e lartpërmendura dhe një takim të përbashkët me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Kryetarët e të dy komunave, me qëllim që këto dy njësi të kthehen nën menaxhimin e KRU-ve, nga të cilat janë ndarë në mënyrë të paligjshme.

ZRRUK, gjatë vitit 2012 ka proceduar Paralajmërime për mos përmbushje të obligimit ligjor të parapar me kuadrin aktual të legjislacionit primar dhe sekondar, për mosposedim të licencës së punës për: KUM’Ibar’ Zubin Potok, JKP’Vodovod Ibar’ Mitrovica, KUM’24 nëntor’ Leposaviç, NPK’Ujësjellësi & Higjiena’ Deçan, Drejtoria e Shërbimeve Publike Hani i Elezit, NPK’Lypoteni’Kaçanik.

Në momentin kur ZRRUK ka vendosur të shqiptoj gjoba ndaj të lartëpërmendurave, ka hyrë në fuqi Ligji Nr.04/L-111, Për Ndryshimin edhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike. Neni 6 i po këtij Ligji u jepë të drejtë komunave për të krijuar ndërmarrje publike lokale në pajtim me kriteret e përcaktuara me akt nën-ligjor të Qeverisë. Andaj nuk kemi mundur të marrim masa ligjore derisa Qeveria e Republikës së Kosovës të nxjerrë dhe aprovoj Rregulloren mbi formimin e ndërmarrjeve lokale.

(ii) Kompania e Licencuar për Furnizim të Ujit me Shumicë

Furnizimi i ujit me shumicë me ligjin nr. 03/L-086 është përkufizuar si furnizimi i ujit të papërpunuar për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza.

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

- 1. “Ibër-Lepenci” Sh.A.** e cila furnizon ujë të papërpunuar me shumicë për KRU “Mitrovica” Sh.A. dhe KRU “Prishtina” Sh.A.

Licenca e “Ibër –Lepenci” është valide 31 tetor 2012 deri më 31 tetor 2015.

Figura 1: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit



KUR Prishtina	KUR Hidroregjioni Jugor	KUR Hidrodrini	KUR Mitrovica	KRU Radoniqi	KRUK Bifurkacioni	KRUK Hidromorava	Komunitat jashtë shërbimeve nga KUR-të
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliçi -Lipjani -Drenasi -Shtime -Graçanica	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi	-Peja -Klina -Istogu -Juniku	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtrria	-Gjakova -Rahoveci	-Ferizaji	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novobërda -Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca -Kaçaniku -Deqani

3.2. PERFORMANCA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

Monitorimi i Performances së kompanive publike të licencuara, të cilat ofrojnë shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit, është njëra prej përgjegjëseve më të rëndësishme të ZRRUK. Ky është një mekanizëm shumë i rëndësishëm Rregullator dhe mjet i fuqishëm i menaxhimit të sektorit të shërbimeve të ujit, dhe është në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë sektor. Fillimisht siguron të dhëna të vlefshme për gjendjen aktuale në sektorin e ujit, si dhe vlerëson pikat më të dobëta të cilat kanë nevojën më të madhe për tu përmirësuar. Në përgjithësi ZRRUK, përmes këtij procesi, synon përmirësimin e vazhdueshëm të Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

Çdo vit ZRRUK monitoron dhe vlerëson performancën e kompanive publike të licencuara, të cilat ofrojnë shërbime të ujit dhe kanalizimit dhe për të gjitha palët e interesit (Kuvendin e Kosovës,

Qeverinë, Donatorët, Konsumatorët), ofron të dhëna dhe raporte për arritjet, dështimet dhe problemet që ofruesit e shërbimeve kanë pasur gjatë vitit 2012.

Duke pasur parasysh se kompanitë që ofrojnë këto shërbime kanë monopol në Republikën e Kosovës, monitorimi dhe vlerësimi i ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit është tejet i rëndësishëm. Në radhë të parë për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve, për të siguruar dhe ngritur transparencën e punës së kompanive, si dhe për të stimuluar konkurrencën mes tyre, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të shërbimeve

Monitorimi i performancës bëhet në bazë të raporteve të cilat këto ndërmarrje i dorëzojnë në ZRRUK në baza mujore dhe Raportimin vjetor, në pajtim me obligimet e tyre raportuese që kanë ndaj ZRRUK.

Vlerësimi i performancës është bërë për 7 (shtatë) KRU-të e licencuara, bazuar në raportet dhe të dhënat e ofruara nga kompanitë.

(Të dhënat e shfrytëzuara në këtë raport për vitin 2011 janë të auditua/verifikuara, ndërsa të dhënat e vitit 2012 do të auditohen/verifikohen në muajin Prill të këtij viti (edhe pse të pa audituara këto të dhëna janë të mjaftueshme për të na dhënë një pasqyrë orientuese).

Pasqyra më objektive me të dhënat e verifikuara të vitit 2012 do të paraqitet përmes “Raportit Vjetor të Performancës” i cili do të publikohet në Qershor 2013 nga ZRRUK.

Në dy kapitujt më poshtë, përmes disa prej Treguesve Kyç të Performancës është paraqitur “Performanca e Përgjithshme” (në nivel të sektorit) dhe “Performanca individuale”(për shtatë KRU-të e licencuara që ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit në Republikën e Kosovës).

Treguesit e paraqitur në këtë raport janë disa nga Treguesit Kyç të Performancës (TKP) dhe janë prezantuar për arsye se përveq rëndësisë që këta tregues kanë në performancën e sektorit, ekziston edhe mundësia e përmirësimit të tyre nga ana e kompanive përmes një menaxhimi më efikas.

Diagramet e paraqitura kanë qëllim ti mundësojnë lexuesit e këtij raporti vështrim më të lehtë në rezultatet, arritjet, dështimet dhe caqet e aktiviteteve që ofruesit e këtyre shërbimeve kanë pasur gjatë vitit 2012.

3.2.1 Performanca e Përgjithshme

Në këtë kapitull është paraqitur pasqyra e performancës së përgjithshme në nivel të sektorit të Shërbimeve të ujit dhe të kanalizimit në Republikën e Kosovës, për periudhën raportuese 2012, me ç’rast janë përdorur të dhëna statistikore dhe tregues për një periudhë kohore 5 vjeçare (me qëllim të një pasqyrimi më të plotë të zhvillimit të sektorit në përgjithësi).

3.2.1.1 Mbulueshmëria me Shërbime të Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Mbulueshmëria me shërbime të Ujësjellësit dhe Kanalizimit nënkupton përqindjen e popullsisë që ka qasje në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur raporti mes popullsisë që ka qasje në shërbime në krahasim me popullatën e përgjithshme.




Figura 2, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit, gjatë 5 viteve të fundit

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit në vitin 2012, ka arritur nivelin prej 78% dhe në krahasim me vitin 2008 është shënuar përmirësim për 18%.

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit në vitin 2012 ka arritur vlerën prej 56% dhe në krahasim me vitin 2011(apo 2008) ka shënuar përmirësim për 5% .

Në krahasim me mbulueshmërinë me shërbime të ujësjellësit, niveli i mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimit është 22% më i ultë.

Rritja e zonës së shërbimeve (mbulueshmërisë) me ujësjellës dhe kanalizim gjatë kësaj periudhe (2008-2012) kryesisht është rezultat i investimeve nga donacionet, si dhe investimeve nga KRU dhe Komunitat.

3.2.1.2 Uji i Prodhuar, Shitjet dhe Uji i Pafaturuar

Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur UPF (Uji i pa faturuar) në raport me ujin e prodhuar dhe ujin e shitur (Faturuar).

UPF është ndryshimi mes ujit të prodhuar dhe ujit të faturuar (sasia e cila është shitur)




Figura 3, Prodhi i ujit, shitjet dhe uji i pa-faturuar

Krahasuar me rritjen e vazhdueshme të numrit të konsumatorëve edhe prodhi i ujit gjatë viteve 2008 - 2011 ka shënuar rritje të arsyeshme në nivel të sektorit.

Gjatë vitit 2012, është raportuar rënje e prodhimit të ujit si pasojë e sasisë më të vogël të ujit të prodhuar nga KRU “Radoniqi” dhe “Bifurkacioni”.

Si përmblendje e përgjithshme gjatë vitit 2012, nga shtatë KRU janë prodhuar dhe shpërndarë tek konsumatorët mbi 138 milion m³ ujë të pijshëm dhe është për rreth 8 milion m³, më pak se në vitin 2011.

Uji i faturuar gjatë vitit 2012 është rreth 58 milion m³ dhe është rreth 2 milion m³, më tepër se në vitin 2011.

Faturimi i ujit gjatë periudhës 5 vjeçare (2008 – 2012), ka shënuar një përmirësim shumë të vogël. Sipas të dhënave rezulton se UPF në Kosove është 58% e sasisë totale të ujit të prodhuar-shprehur në sasi kjo është 80 milion m³.

Nëse kjo shifër shumëzohet me çmimin aktual (që në Kosovë mesatarja është 0,31€ për konsumatorët e amvisërisë) arrijmë te rezultati se humbjet e ujit shkaktojnë me së paku 25 milion Euro humbje vjetore për kompanitë e licencuara.

3.2.1.3 Faturimi dhe Arkëtimi

Shiqvar në përgjithësi faturimi dhe arkëtimi është duke u përmirësuar nga KRU-të. Edhe pse ky përmirësim është gradual vlen të theksohet se është i qëndrueshëm.




Figura 4, Faturimi dhe arkëtimi aktual

Efiçenca e Qarkullimit¹, në vlerë monetare në nivel sektori gjatë vitit 2012, ka shënuar përmirësim për 2,787,569 € apo shprehur në përqindje për 11% në raport me vitin 2011.

Efiçenca e arkëtimit, në vitin 2012 po ashtu ka shënuar përmirësim në vlerë monetare për 2,220,868€, apo shprehur në përqindje për 13% në krahasim me vitin 2011.

Ky përmirësim më shumë është rezultat i ngritjes së tarifave të ujit, shtimit të numrit të konsumatorëve dhe më pak i efikasitetit të kompanive për faturimin e ujit të konsumuar.

Shkalla e arkëtimit në raport me faturimin në nivel të sektorit në vitin 2012 është 70% apo 1%, më e lartë se në vitin 2011.

¹ Qarkullimi ka përfshirë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të kanalizimit, si dhe të hyrat nga aktivitete të tjera operative,

Keshi ka përfshirë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të kanalizimit, si dhe të hyrat nga aktivitete të tjera operative.

Shiquar në periudhën kohore 5 vjeçare (2008 – 2012) shofim se:

- Arkëtimi në vitin 2012 është për 5% më i lartë se në vitin 2008,
- Qarkullimi në vitin 2012 në vlerë monetare është përmirësuar për 4,643,543, në raport me vitin 2008.

3.2.2. Performanca Individuale e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit

Në këtë kapitull përmes disa prej Treguesëve Kyç të Performancës (TPK) është paraqitur performanca individuale e KRU-ve për periudhën raportuese 2011/2012.

Përmes diagrameve dhe informatave në vijim përveq prezantimit të performancës mund të bëhet edhe krahasimi mes rezultateve të 7 KRU-ve që ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit.

3.2.2.1 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë paraqet përqindjen e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë qasje në shërbime të furnizimit me ujë.




Figura 5, Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit

Të gjitha KRU kanë shënuar përmirësim gjatë vitit 2012 krahasuar me vitin 2011.

Në nivel të sektorit mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit për vitin 2012 është 78% dhe është e përmirësuar për 4%, në raport me vitin 2011.

KRU 'Radoniqi' (me 96%) dhe KRU 'Hidrodrini' (me 94%), janë kompanitë të cilat kanë mbulueshmërinë më të lartë me shërbime të furnizimit me ujë.

KRU 'Hidromorava' (me 57%) ka mbulueshmërinë më të ulët me shërbime të ujësjellësit.

Përmirësim më të madh gjatë vitit 2012 ka shënuar KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 7%, dhe KRU 'Prishtina' me 6%, duke e zgjeruar zonën e tyre të shërbimeve.

3.2.2.2 Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është e definuar si përqindja e popullsisë që kanë qasje në shërbime të kanalizimit.




Figura 6, Mbulueshmëria me shërbimet e kanalizimit

Edhe mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit ka shënuar përmirësim në të gjitha KRU.

Në nivel të sektorit mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit, në krahasim me vitin 2011 është përmirësuar për 5% në vitin 2012.

Shkallën më të lartë të mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimit për vitin 2012 e ka KRU 'Prishtina' me 71%.

Shkallën më të ulët të mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimit për vitin 2012 e ka KRU 'Hidrodrini' me vetëm 41%.

Përmirësim më të madh gjatë vitit 2012 ka shënuar KRU 'Hidroregjioni Jugor' duke zgjeruar zonën e shërbimeve me 13%.

3.2.2.3 Uji i Pafaturuar

Uji i pafaturuar (UPF) paraqet ujin i cili është prodhuar, është shpërndarë por nuk është faturuar (nuk ka arritur të regjistrohet) – ndryshe i quajtur si "ujë i humbur" apo "humbje".

Humbjet mund të jenë si pasojë e rrjedhjeve (humbje fizike) apo si pasojë e këqpërdorimit dhe pasaktësisë gjatë matjes (humbje komerciale).

Niveli i lartë i UPF, ndikon negativisht në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit.




Figura 7, Uji i pa-faturuar

Në vitin 2012, humbjet e ujit janë 60%, kjo është më pak për 1% se sa në vitin 2011.

ZRRUK përmes projektit mbështetës IPA, ka hartuar 'Planin e Pergjithshëm për Reduktimin e UPF', ndërsa nga të gjitha KRU është kërkuar të hartojnë Planet dhe strategjitë e tyre të veçanta (për vendosjen e ujëmatësave, reduktimet e ujit, menaxhimin adekuat të presionit në sistem, sistemin e saktë dhe efektiv të faturimit etj).

Sipas standardeve evropiane, humbjet e pranueshme janë deri në 15%. Në disa vende shumë të zhvilluara siq janë Gjermania dhe Danimarka, humbjet janë edhe më të ulta se ky nivel (rreth 7%). Humbjet e ujit në disa vende të rajonit janë; Shqipëri 62%, Kroaci 42%, Maqedoni 63%, Slloveni 26%.

3.2.2.4 Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës

Politikë e ZRRUK gjatë vitit 2012, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka qenë që të ndikojë tek Konsumatorët por edhe tek Kompanitë që uji i harxhuar nga konsumatorët të matet me ujëmatës.

Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës në përqindje paraqet numrin e konsumatorëve të cilët janë paisur me ujëmatës, në krahasim me numrin e përgjithshëm të konsumatorëve të shërbyer. Matja e ujit është procesi i matjes së ujit të përdorur përmes matësve të ujit.




Figura 8, Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës.

Paisja e Konsumatorëve me ujëmatës është një prej treguesve i cili ka shënuar përmirësime të mëdha.

Gjatë vitit 2012 mbulimi me ujëmatës në nivel mesatar të sektorit është rritur në 91%, nga 81% sa ishte në vitin 2011.

Shkallën më të lartë të përqindjes së konsumatorëve me ujëmatës gjatë vitit 2012 krahasuar me 2011 e ka KRU 'Prishtina' me rritje prej 12%, tregues ky që e qon këtë KRU në 96% të konsumatorëve me ujëmatës.

Ndërsa KRU 'Mitrovica' edhe përkundër një rritjeje prej 8% krahasuar me vitin 2011, prapë ngelet në nivel jo të kënaqshëm me vetëm 59% të konsumatorëve të paisur me ujëmatës.

Perfitimet nga vendosja e ujëmatësave janë të dyanshme, si për konsumatorët ashtu edhe për ofruesit e shërbimeve në ruajtjen e ujit, identifikimin e rrjedhjeve dhe vlerësimin e saktë të UPF.

Paisja e konsumatorëve me ujëmatës në shkallë 91% mund të konsiderohet një sukses nëse bëjmë një krahasim me vendet e rajonit p.sh. Shqiperi 58%, Kroaci 82%, Maqedoni 94%.

3.2.2.5 Shkalla e arkëtimit

Arkëtimi paraqet raportin e mbledhjes së mjeteve financiare në krahasim me mjetet e faturuara gjatë vitit.

Arkëtimi përveq që është i rëndësishëm në aspektin e faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka ndikim vendimtar në qëndrueshmërinë financiare të kompanive.




Figura 9, Shkalla e arkëtimit

Shkalla e arkëtimit për shërbimet e faturuara për vitin 2012 në nivel të përgjithshëm të sektorit është 70% dhe në raport me vitin 2011 ka rritje për 1%.

Shkallën më të lartë të arkëtimit për vitin 2012 e ka arritur KRU 'Radoniqi' me 77%, ndërsa me shkallën më të ulët të arkëtimit për vitin 2012 është KRU 'Mitrovica' me 50%.

Gjatë vitit 2012 përveq KRU 'Radoniqi' (me 6%) dhe KRU 'Prishtina' (me 4%), të cilat kanë pasur rritje të arkëtimit si dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' i cili ka mbet në nivel të njëjtë të arkëtimit, të gjitha kompanitë tjera kanë shënuar rënije të arkëtimit krahasuar me vitin 2011.

Caku i Planifikuar për 2012 në nivel të sektorit ka qenë 73%, përderisa aktualisht në nivel të sektorit është arritur të arkëtohen vetëm 70% të shumës së faturaur.

3.2.3. Performanca e NHE 'Iber Lepenci'

ZRRUK është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Iber Lepenci', e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' (për Nj.O 'Drenas'). Në vazhdim po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendet e zhvillimit të performancës në vitin 2012 në raport me vitin 2011.

Në tabelen nr.1, është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të cilëve mundë të vlerësohet performanca e NHE 'Iber Lepenci' gjatë vitit 2012 krahasuar me vitin 2011.

Tabela nr.1, Performanca e NHE 'Iber-Lepenci'

Treguesi i performancës	2011	2012
Shkalla e arkëtimit	215% ²	95%
Norma e punës	0.95	1.21
Norma e mbulimit të punës	2.05	1.15
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.019	0.018

3.3. TARIFAT E SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIM

Me fillimin e vitit 2012 ZRRUK ka filluar zbatimin e dytë të procesit tarifar 3 vjeçar 2012- 2014, si një nga aktivitetet kyçe të tij. Ky aktivitet ka pas për obligim tu ofroj mbështetje operative dhe institucionale ofruesve të shërbimeve të ujit, për implementim të vendimeve të dala nga procesi rregullator i tarifave, monitorim, krahasim dhe vlerësim të rezultateve të arritura, duke i ndërlidhur të njëjtat me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caceve të çdo treguesi kryesorë të identifikuar si të tillë.

Në bazë të të dhënave të mbledhura nga monitorimi i afarizmit të KRU-ve dhe analizave të bëra nga të dhënat e tilla të vitit 2012, duke u mbështetur edhe në mandatin ligjorë që kemi, ZRRUK, për vitin 2013 ka përcaktuar tarifat e ujit të trajtuar me pakicë për shtatë (7) kompani regjionale, një tarifë të ujit me shumicë, si dhe të një tarifë të ujit të pa trajtuar me shumicë nga NHE 'Iber-Lepenci' sh. a. Prishtinë.

Tarifat e vitit 2013 vlejnë nga 1 janari 2013 gjer më 31 dhjetor 2013.

Gjatë llogaritjes dhe përcaktimit të tarifave për shërbimet e ujit të procesit rregullatorë 2012-2014, kemi marr parasysh një mori faktorësh të cilët i kanë determinuar tarifat, nga të cilët duhet përmend; kërkesat e konsumatorëve për furnizim me ujë, mundësitë teknike të prodhimit të ujit, gjendjen aktuale të rrjetit shpërndarës, shumën e kostove operative dhe ato të investimeve kapitale, qëndrueshmëria financiare e ofruesve të shërbimeve, mbrojtja e konsumatorëve, rrethanat ekzistuese në vend etj., nga të cilat janë përcaktuar edhe caqet të cilat duhet të përmbushen nga KRU-të vit pas viti.

Në tekstin e mëtejshëm të kësaj pjese të raportit është paraqitur shkalla e përmbushjes së caceve të disa treguesve kryesorë të shtatë (7) KRU-ve dhe sektorit si tërësi gjatë vitit 2012.

Të dhënat e paraqitura në këtë pjesë të raportit për vitin 2012, janë të dhëna preliminare – akoma të pa audituara. Këto të dhëna do të saktësohen pas përmbylljes së fazës së auditimit të të dhënave të vitit në fjalë.

Nga të dhënat e monitoruara duhet përmendur:

² Në vitin 2011, 'NHE Iber Lepenci' ka arritur të arkëtojë borxhet paraprake për vitet e kaluar nga KRU 'Mitrovica'

PS. ZRRUK- Vlerësimin e Shkallës së arkëtimit e llogarit sipas kontabilitetit mbi bazën monetare, I cili të ardhurat dhe shpenzimet I njeh kur ato arkëtohen ose paguhen.

- të dhënat operative,
- të dhënat financiare, dhe
- të dhënat e realizimit të projekteve investive kapitale

3.3.1 Të dhënat Financiare

Treguesit kyç të cilët përcaktojnë dhe japin një pasqyrë më të qartë financiare janë shpenzimet operative, faturimi dhe arkëtimi, shkalla e mbulueshmërisë së shpenzimeve operative me të hyrat e realizuar gjatë periudhës së shikuar dhe shkalla e mbulueshmërisë së realizimit të investimeve kapitale.

Në vijim janë paraqitur të dhënat me vlerësimin për përmbushje/mos-përmbushje të caqeve të këtyre treguesve.

3.3.1.1 Përmbushja e caqeve për shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të dhënat sektoriale të shpenzimeve operative të aprovuara nga ZRRUK, për ujë dhe ujëra të zeza dhe ato të realizuar nga kompanitë e shërbimeve të ujit në nivel të sektorit, me % e realizimit të caktuar dhe vlerësimin e përfundimtarë për vitin 2012.

Tabela Nr. 2. Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €

Zërat e shpenzimeve operative	Njësia Monetare	Të Aprovuara 2012	Të Realizuara 2012	Përmbushja e caktuar (%)	Vlerësimi përfundimtarë i shkallës së përmbushjes së caktuar
Ujë	€	14,385,250	18,441,103	128.19%	T
Ujëra të Zeza	€	801,050	965.107	120.48%	T
Totali	€	15,186,300	19,406.201	127.79%	T

Sqarim simboli: T = tejkaluar

Siç është paraqitur edhe në pasqyrën e lartë cekur, në nivel sektori janë tejkaluar shpenzimet e aprovuara në shumën të konsiderueshme (shprehur në përqindje ky tejkalim i kostove operative ka arrit të jetë 27,79%), dhe si të tilla vlerësohen negativisht.

3.3.1.2 Përmbushja e caqeve të faturimit

Edhe në tabelën nr. 3. është paraqitur shumën e përgjithshme të faturimit në nivel të sektorit, e aprovuar nga ZRRUK, e krahasueshme me shumën e të dhënave të tilla të realizuara, % e realizimit të obligimeve të marra për faturim me procesin rregullator të tarifave për vitin 2012 dhe vlerësimin e shkallës së përmbushjes së këtij caku.

Tabela Nr. 3. Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujëra të zeza në vlerë monetare

Të dhënat e faturimit	Nj. Monetare (Euro)	Të Aprovuara 2012	Të Realizuara 2012	Përmbushja e caktuar (%)	Vlerësimi përfundimtarë i shkallës së përmbushjes së caktuar
Ujë	€	28,300,140	24,692,530	87.25%	Jo-R
Ujëra të Zeza	€	3,595,595	2,924,431	81.33%	Jo-R
Totali	€	31,895,735	27,616,961	86.59%	Jo-R

Sqarim i simboleve: R = realizuar
Jo-R = jo realizuar
T = tejkaluar

Siç shihet edhe nga të dhënat e Tabelës Nr. 3, caqet e aprovuara nga procesi rregullator për vitin 2012 nuk janë përmbushur as për këtë tregues dhe në këtë rast vlerësimi i performancës së kompanive është negativ.

Në nivel sektori mospërmbushja e caceve të faturimit në total e shprehur në përqindje është 13,41%.

3.3.1.3 Përmbushja e caceve të arkëtimit

Edhe këtë grupim të të dhënave sektoriale do ta paraqesim në formë tabelore, duke i identifikuar shumën e arkëtimit të aprovuar nga ZRRUK dhe atë të realizuar nga sektori gjatë vitit 2012, krahasimet në %, si dhe shkallën e përmbushjes së caceve për këto të dhëna.

Tabela Nr. 4. Pasqyra e të dhënave të arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza në vlerë monetare

Të dhënat e faturimit	Nj.Monetare (Euro)	Të Aprovuara 2012	Të Realizuara 2012	Përmbushja e cakt (%)	Vlerësimi përfundimtarë i shkallës së përmbushjes së cakt
Ujë	€	20,661,274	17,284,174	83.65%	Jo-R
Ujëra të Zeza	€	2,662,109	2.005.049	75.32%	Jo-R
Totali	€	23,323,383	19,289,223	82.70%	Jo-R

Sqarim i simboleve: R = realizuar
Jo-R = jo realizuar
T = tejkaluar

Siç shihet edhe nga të dhënat e kësaj tablele, 4 caqet e aprovuara nga procesi rregullator për vitin 2012 për këtë tregues nuk janë përmbushur dhe në këtë rast vlerësimi i performancës së sektorit në shërbimin publik të ujit është negativ.

Në nivel sektori mospërmbushja e caceve të faturimit në total e shprehur në përqindje është 17,3%.

3.3.1.4 Të dhënat e shkallës së mbulueshmërisë së shpenzimeve operative të drejtpërdrejta nga arkëtimi i realizuar gjatë vitit 2012

Në tabelën nr. 5, janë pasqyruar të dhënat e shumave të arkëtuara të secilës kompani veç e veç dhe në nivel sektori, sikurse që janë pasqyruar edhe të dhënat e shumave të shpenzimeve operative të drejtpërdrejta, të cilat janë krahasuar si të tilla, duke vlerësuar rezultatet e tillë të dala gjatë vitit 2012.

Tabela Nr. 5. Shkalla e mbulueshmërisë së shpenzimeve operative të drejtpërdrejta nga arkëtimi për vitin 2012

Nr	Emri i kompanisë	Arkëtimi	Shpenzimet operative pa amortizim	Mbetja Financiare	Koeficienti i shkallës së mbulueshmërisë	Vlerësimi përfundimtarë
		€	€	€	€	
	A	B	C	D=(B-C)	F=B/C	
1	Prishtina	9,391,057	8,872,731	518,326	1.06	K
2	Mitrovica	1,165,337	2,069,054	-903,717	0.56	Jo-K

3	Hidrodrini	1,720,016	1,604,963	115,052	1.07	K
4	Radoniqi	2,356,735	2,108,999	247,736	1.12	K
5	Hidroregjioni-Jugor	2,693,922	2,749,595	-55,673	0.98	Jo-K
6	Bifurkacioni	782,612	785,462	-2,850	1.00	K
7	Hidromorava	1,179,544	1,215,405	-35,861	0.97	Jo-K
	Të dhënat sektoriale	19,289,223	19,406,210	-116,987	0.99	Jo-K

Sqarim i simboleve: K = kënaqshëm

Jo-K = jo i kënaqshëm

Nga të dhënat e shikuara të arkëtimit për vitin 2012 shihet se nga 7 kompani regjionale, 4 kanë mbuluar shpenzimet e veta operative me shumën e mjeteve të arkëtuara, ndërsa 3 nga to jo.

Rasti më specifik është KRU 'Mitrovica', e cila nuk arkëton shumën e faturimit për furnizim me ujë të përpunuar të pjesës veriore të qytetit të Mitrovicës, por NJPMNP pranë MZHE e Qeverisë së Republikës së Kosovës subvencionon disa nga kostot e operimit të saj, për ti mbuluar shpenzimet e prodhimit dhe ndihmuar afarizmin e saj.

Shuma e subvencionit të paguar nga buxheti i Republikës së Kosovës për KRU 'Mitrovica' sh. a. Mitrovicë gjatë vitit 2012 ka qenë 694,152.66 €.

3.3.2. Përbushja e caqeve për investimet kapitale

Në këtë pjesë të raportit janë paraqitur shumat e aprovuara të investimeve kapitale të financuara nga burimet vetanake të kompanive dhe ato të investimeve të premtuara nga donatorët gjatë vitit 2012 dhe shumat e projekteve të realizuara nga të dy burimet e identifikuara të financimit, me të dhënat e sektorit për të njëjtët indikatorë.

Gjithashtu është paraqitur edhe përqindja e përbushjes së caqeve të investimeve kapitale si nga burimet vetanake ashtu edhe ato të donatorëve, me vlerësimin tonë përfundimtarë për caqet e arritura.

3.3.2.1. Përbushja e caqeve të investimeve kapitale për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza të financuara nga burimet vetanake të kompanive

Në pasqyrën e më poshtme janë paraqitur të dhënat e investimeve kapitale të financuara nga mjetet vetanake të çdo kompanie veç e veç dhe në nivel të sektorit.

Tabela Nr. 6 Shumat e investimeve kapitale nga burimet vetanake

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Aprovuara nga ZRRUK 2012	Realizuara nga KRU 2012	Realizimi i caktuar 2012 (%)	Vlerësimi përfundimtarë
Prishtina (PR)	Ujë	€	5,791,048	652,231	11.26%	
	Ujëra të zeza	€	761,285	25,612	3.36%	
	Investimet në			814,013		
	Totali	€	6,552,334	1,491,856	22.77%	Jo-R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	363,346	198,181	54.54%	
	Ujëra të zeza	€	157,227	10,839	6.89%	
	Totali	€	520,573	209,020	40.15%	Jo-R
Hidrodrini	Ujë	€	377,958	111,434	29.48%	

(PE)	Ujëra të zeza	€	25,858	0	0.00%	
	Totali	€	403,816	111,434	27.60%	Jo-R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	0		0.00%	
	Ujëra të zeza	€	139,931	0	0.00%	
	Totali	€	139,931	0	0.00%	Jo-R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	409,646	148,775	36.32%	
	Ujëra të zeza	€	139,931	0	0.00%	
	Totali	€	549,576	148,775	27.07%	Jo-R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	118,898	43,379	36.48%	
	Ujëra të zeza	€	203,967	9,565	4.69%	
	Totali	€	322,864	52,943	16.40%	Jo-R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	273,580	88,764	32.45%	
	Ujëra të zeza	€	119,042	0	0.00%	
	Totali	€	392,622	88,764	22.61%	Jo-R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	7,334,476	2,056,778	28.04%	Jo-R
	Ujëra të zeza	€	1,547,241	46,015	2.97%	Jo-R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	8,881,716	2,102,793	23.68%	Jo-R

Sqarim i simboleve: R = realizuar

Jo-R = jo realizuar

Siç shihet edhe nga të dhënat e pasqyruara më lartë, asnjë nga KRU-të nuk ka arritur t'i përmbushë caqet për realizimin e investimeve kapitale të aprovuara me procesin rregullator të tarifave të vitit 2012.

Dështimi i përmbushjes së caqeve në nivel të përgjithshëm të sektorit prej 76.32% është tregues tejet negativ.

3.3.2.2. Përmbushja e caqeve të investimeve kapitale për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza të financuara nga donatorët

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të dhënat e investimeve kapitale të aprovuara nga kompanitë dhe ZRRUK, për realizim sipas premtimeve të donatorëve kompani për kompani dhe në nivel të sektorit për vitin 2012, me shumën e projekteve të investimeve kapitale të realizuara gjatë të njëjtës periudhë kohore, përqindjen (%) e realizimit të caqeve, me vlerësimin tonë përfundimtarë.

Tabela Nr. 7. Shumat e investimeve kapitale nga donatorët

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Shumat e aprovuar për realizim gjatë vitit 2012	Të Realizuar 2012	Realizimi i caktuar 2012 (%)	Vlerësimi përfundimtarë
Prishtina (PR)	Ujë	€	5,811,986	163,617	2.82%	
	Ujëra të zeza	€	1,853,743	0	0.00%	
	Totali	€	7,665,730	163,617	2.13%	Jo-R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	4,173,138	3,074,311	73.67%	
	Ujëra të zeza	€	853,483	46,471	5.44%	
	Totali	€	5,026,621	3,120,781	62.09%	Jo-R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	2,097,414	3,264,167	155.63%	
	Ujëra të zeza	€	2,261,917	1,722,830	76.17%	
	Totali	€	4,359,330	4,986,997	114.40%	Jo-R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	11,201,628	51,960	0.46%	
	Ujëra të zeza	€	3,598,504	0	0.00%	
	Totali	€	14,800,131	51,960	0.35%	Jo-R
Radoniqi	Ujë	€	154,222	241,701	156.72%	

(GJA)	Ujëra të zeza	€	10,281	0	0.00%	
	Totali	€	164,503	241,701	146.93%	Jo-R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	750,545	647,139	86.22%	
	Ujëra të zeza	€	821,682	0	0.00%	
	Totali	€	1,572,227	647,139	41.16%	Jo-R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	859,528	901,031	104.83%	
	Ujëra të zeza	€	0	37,106	!	
	Totali	€	859,528	938,137	109.15%	Jo-R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	25,048,460	8,343,926	33.31%	
	Ujëra të zeza	€	9,399,610	1,806,407	19.22%	
Totali i përgjithshëm sektorial		€	34,448,070	10,150,332	29.47	Jo-R

Sqarim i simboleve: R = realizuar

Jo-R = jo realizua

Siç shihet edhe nga kjo pasqyrë, investimet e premtuara nga donatorët as për së afërmi nuk janë përmbush edhe pse të njëjtat nuk i kanë ngarkuar tarifat e shërbimeve të ujit.

Dështimi i përmbushjes së caqeve nga investimet e donatorëve në nivel të përgjithshëm të sektorit është 70.53%.

3.3.2.3 Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit për vitin 2013

Nga obligimet rregullatore të procesit rregullatorë 2012-2014 të marra nga ZRRUK, kanë rrjedh obligimet e përcaktimit të tarifave të periudhës së shërbimit të ujit për aplikim gjatë vitit 2013.

Gjatë rishikimit dhe përcaktimit të tarifave për vitin 2013 janë analizuar dhe marrë parasysh lëvizjet inflatore të periudhës tetor 2010-dhjetor 2012, shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara nga procesi rregullator për vitin 2012, duke vënë theks të veçantë shkallës së realizimit të investimeve kapitale, të financuara nga tarifat e përcaktuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi.

ZRRUK, për këtë vit tarifar ka aplikuar mënyrën më reale të mundshme ekzistuese të përcaktimit të tarifave të periudhës së theksuar, duke e ndërlidhë shkallen e përmbushjes së caktit të investimeve kapitale për çdo kompanie veç e veç me Indeksin e Konsumit të Çmimeve në Kosovë (IÇKK) për periudhën e shikuar, publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Tarifat volumetrike të shërbimeve të furnizimit me ujë në terma reale janë ngrit-përshtatë sipas raportit të shkallës së përmbushjes së caqeve të realizuara për investime kapitale, të përcaktuara për çdo kompani veç e veç gjatë vitit 2012 dhe shkallës së IÇKK, publikuar nga ASK-ë për periudhën tetor 2010-dhjetor 2012, e cila ka rezultuar me ngritjen mesatare të tarifave volumetrike për konsumatorët shtëpiakë për 0.02 €/m³ (shprehur në përqindje-5.65%) gjatë vitit 2013, në krahasim me tarifat e tilla të vitit 2012, ndërsa tarifat e grupimit të konsumatorëve jo-shtëpiakë kanë pësuar një ngritje prej po ashtu 0.02€/m³ (shprehur në përqindje 2.16%).

Për ta rrumbullakuar gjithë atë që theksuam më lartë në vijim po i pasqyrojmë edhe të dhënat për tarifat e vitit 2013, të cilat janë të vlefshme deri me 31 dhjetor 2013.

Edhe tarifat e vitit 2014 do të përcaktohen sipas politikave dhe metodologjisë së tarifave të caktuara të vitit 2013.

Rregullatori ka pas dhe do të ketë në konsideratë edhe në të ardhmen përbalueshmerinë e pagesës së faturave të lëshuara nga kompanitë për shërbimet e ujit që i ofrojnë, nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer.

Tabela 8: Tarifat e aprovuara për aplikim gjatë vitit 2013 (me ngjyrë të gjelbërt) për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit nga procesi rregullator i tarifave afatmesme 2012-2014

Kompania Regjionale	Kategoria e tarifave	Njësia	Tarifa për Konsumatorët Shtëpiak			Tarifa për Konsumatorët Jo-shtëpiak		
			2012	2013	2014	2012	2013	2014
KUR 'PRISHTINA' Prishtinë	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.37	0.38	0.3859	0.87	0.87	0.8682
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.05	0.05	0.0556	0.11	0.11	0.1251
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.42	0.43	0.4415	0.98	0.98	0.9933
KUR 'HIDROREGJIONI JUGOR' Prizren	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.31	0.35	0.3722	0.61	0.69	0.7072
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.05	0.05	0.0600	0.09	0.09	0.0979
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.36	0.40	0.4322	0.70	0.78	0.8051
KUR 'HIDRODRINI' Pejë	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.22	0.23	0.2474	0.43	0.47	0.4454
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.06	0.06	0.0719	0.12	0.13	0.1439
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.28	0.29	0.3193	0.55	0.60	0.5893
KUR 'RADONIQI' Gjakovë	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.33	0.35	0.3684	0.72	0.70	0.6631
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.07	0.08	0.1089	0.16	0.21	0.2724
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.40	0.43	0.4773	0.88	0.91	0.9355
KUR 'MITROVICA' Mitrovicë	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.33	0.35	0.3841	0.73	0.70	0.6913
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.08	0.10	0.1339	0.20	0.26	0.3347
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.41	0.45	0.5180	0.93	0.96	1.0260
KUR 'HIDROMORAVA' Gjilan	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.32	0.33	0.3256	0.71	0.65	0.5861
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.08	0.08	0.0855	0.19	0.20	0.2137
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.40	0.41	0.4111	0.900	0.85	0.7998
KUR 'BIFURKACIONI' Ferizaj	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.31	0.32	0.3279	0.68	0.64	0.5902
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.13	0.13	0.1417	0.30	0.33	0.3542
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.44	0.45	0.4696	0.98	0.97	0.9444

Tarifa e ujit të pa trajtuar të furnizuar nga NH 'Ibër-Lepenc':

- Për KRU 'Mitrovica' gjatë vitit 2013 është përcaktuar të jetë 0.0184 €/m3,
- Për KRU 'Prishtina' gjatë vitit 2013 është përcaktuar të jetë 0.0455 €/m3,

Tarifa e ujit me shumicë të trajtuar me të cilën faturohet pjesa veriore e Qytetit të Mitrovicës është përcaktuar në 0.17 €/m3.

Këto tarifa janë të vlefshme gjatë tërë vitit 2013.

Mbi tarifat e përcaktuara për vitin 2013 kompanitë e shërbimeve publike të ujit janë të obliguara të kalkulojnë edhe TVSH-ën e aplikueshme në vend.

Për të bërë disa krahasime të tarifës mesatare volumetrike të konsumatorëve shtëpiakë në vendin tonë, me tarifat e tilla të grupimit të njëjtë në disa qytetet të regjionit, po i pasqyrojmë të njëjtat në një tabelë të thjeshtësuar. Tarifat e tilla janë identifikuar me 9 shkurt 2013 nga ueb-faqet e publikuar të qendrave të tilla në regjion, të konvertuara në euro.

Tabela Nr. 9. Tarifat e shërbimeve të konsumatorëve shtëpiakë dhe jo shtëpiak në nivel të regjionit të krahasueshme me tarifën e tillë mesatare në Kosovë për vitin 2013.

Vendet e identifikuar të tarifave në regjion sipas kategorive të konsumatorëve		Tarifat e shërbimeve të ujit (ujësjellës+kanalizim) vitit 2013 (€/m ³)
Kosovë	Shtëpiak	0.41
	Jo-shtëpiak	0.86
Shqipëri	Klientët familjar	0.41
	Klientët privat	1.14
	Institucione	0.94
Shkup (Konsumatorë shtëpiak)		0.47
Novi Sad (Konsumatorë shtëpiak)		0.67
Podgoricë (Konsumatorë shtëpiak)		0.34
Sarajevë (Konsumatorë shtëpiak)		0.51
Zagreb (Konsumatorë shtëpiak)		1.70

Nga të dhënat e lartë cekura të kësaj pasqyre mund të theksohet se tarifat e shërbimeve në vendin tonë, s'bashku me mesataren e tarifave të tilla janë më të ulëtat në regjion, duke përjashtuar Podgoricën, pasi që tarifat e shtëpiakëve të këtij qytetit janë përcaktuar për herë të fundit gjatë vitit 2008 dhe si të tilla kanë mbet edhe në ditën kur është kontaktuar ueb faqja e kompanisë së këtij qyteti.

Tarifat e finalizuara (mesatare të ponderuara) të rregulluara për inflacion në përputhje me procedurat tarifore të ZRRUK për vitin 2013 janë të paraqitura në Tabela nr. 10.

Tabela nr. 10, Mesatarja e ponderuar e tarifave finale të kategorisë së konsumatorëve shtëpiakë për vitin 2013 duke marr në konsideratë edhe shkallen e realizimit të investimeve dhe inflacionit

Kategoria e konsumatorëve	Furnizimi me ujë (EUR për m ³ të ujit të shitur)	Shërbimet për ujëra të zeza (EUR për m ³ të ujit të shitur)	Tarifa volumetrike për shërbimet e ujit për vitin 2013 (EUR për m ³ të ujit të shitur)
Shtëpiak	0.33	0.08	0.41
Komercial	0.67	0.19	0.86
Institucional	0.67	0.19	0.86

Çdo konsumatorë i shërbyer ngarkohet edhe me tarifën fikse mujore prej 1.00 €/muaj/konsumatorë dhe TVSH-n e aplikueshme në vend.

Tabela nr. 11. Pasqyra sektoriale e ngritjes së tarifave volumetrike të shërbimeve të ujit me tregues të lëvizjeve të tyre gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012

Tarifat	Kategoritë e konsumatorëve	Tarifa Fikse mujore €/m/k	Tarifa volumetrike komulative 2013 (€/m3)	% ngritjes së tarifës pa inflacion 2013/2012	% ngritjes së tarifës me inflacion 2013/2012	% ngritjes së tarifës me ponderimin e realizimit të investimeve kapitale në shkallën e IÇKK nga ASK 10/2010-12/2012
Tarifa baze e vitit 2012	Shtëpiak	1.00	0.3871			
	Jo-shtëpiak	3.00	0.8457			
Tarifa për vitin 2013 pa inflacion	Shtëpiak	1.00	0.4008	3.5277		
	Jo-shtëpiak	3.00	0.8441	-0.1875		
Tarifa e paraparë për vitin 2013 me inflacion	Shtëpiak	1.00	0.4375		13.005	
	Jo-shtëpiak	3.00	0.9213		8.938	
Tarifat finale 2013 me % e realizimit të projekteve 2012	Shtëpiak	1.00	0.4090			5.6458
	Jo-shtëpiak	3.00	0.8640			2.1622

Tarifat e vitit 2013 janë kombinim i metodologjisë së planifikuar të përcaktimit të tarifave të procesit rregullator të tarifave të viteve 2012-2014 për vitin 2013 dhe shkallës së investimeve të realizuara të çdo kompanie veç e veç, të pasqyruara në nivel të sektorit në pasqyrën e lartë cekur.

Formati i Politikave tarifore për këtë rast konsiston në faktin se tarifat bazë për vitin 2013 janë indeksuar me shkallën e Indeksit të Çmimit të Konsumit në Kosovë (IÇKK) për periudhën inflatore; tetor/2010-dhjetor/2012 publikuar nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK) dhe shkallës së përmbushjes së caqeve për investimet kapitale të realizuar, të cilat në nivel të vendit janë ngritë vetëm 5.64 për ujë dhe vetëm 2.16% për ujëra të zeza).

Nga kjo mund të konkludohet se tarifat e shërbimeve të ujit për vitin 2013 janë ma të vogla se projeksionet e planifikuara për 0.0285 €/m3, ose shprehur në %, ngritja e tarifave ka rezultuar të jetë më e ultë se grupimi i konsumatorëve shtëpiakë nga baza fillestare e planifikuar vjetore e mesatares për furnizim të ujit prej 6.51%.

Ndërsa ajo e jo-shtëpiakëve është ma e ulët për 6.22%.

3.3.2.4. Procedurat e eliminimit dhe standardizimit të faturimit të paushallit

Gjatë analizimit të raporteve nga KRU-të kemi vërejtur se praktikatat të cilat KRU-të i kanë përdorë për ngarkesat në faturimin e konsumatorëve të cilët nuk kanë pas një ujëmatës të instaluar, ose ai ka qenë jo funksional (paushall), kanë qenë të ndryshme dhe të larta.

Me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe lehtësimit të punës për KRU-të (për të pasur një bazë reale të konsumit për faturim), ZRRUK si hap të parë për përmirësimin e kësaj dukurie gjatë amandamentimit të Rregullës për Standardet Minimale të Shërbimit ka miratuar “Udhëzuesin për përcaktimin e faturimit për Konsumatorët pa ujëmatës”, udhëzues i cili ka filluar të zbatohet nga 1 shtatori 2012.

Për të realizuar vizionin e vet ZRRUK ka mbështetur KRU-të për nxjerrjen e konsumit mesatarë të ujit të matur të të gjitha grupimet e konsumatorëve veç e veç, të cilat janë pasqyruar në një

pasqyrë të veçantë, nxjerr procedurat e veprimit dhe në fund janë aprovuar Vendimet për secilën kompani, në të cilat procedura përveç tjerash për të qenë sa më transparent dhe korrekt janë detaizuar nënkategoritë e konsumatorëve; nga 3 kategori sa kanë qenë më herët në 11 nënkategori p.sh. kategoria e konsumatorëve shtëpiak-është nda në nën-kategorinë e konsumatorëve të shërbyer në: (1) apartamente banimi; (2) shtëpi urbane; (3) shtëpi gjysmë rurale. Sikurse është vepruar edhe për kategoritë tjera të konsumatorëve duke i marrë parasysh specifikat e veçanta.

Për të gjitha këto nënkategori janë nxjerrë mesataret e ngarkesave (duke shfrytëzuar të dhënat nga kategoritë e njëjta të konsumatorëve me ujëmatës) të cilat janë aprovuar nga ZRRUK së bashku me procedurat interne.

Përmes vendimeve të ZRRUK është kërkuar nga KRU-të që të fillojnë zbatimin e këtyre ngarkesave nga 1 shtator 2012.

Në vijmë po pasqyrojmë formatin e procedurave për kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë për regionin e Prishtinës si rast më i veçantë për shkak të shtrirjes së saj gjeografike.

Tabela Nr. 12 Pasqyra e të dhënave për faturim të paushallit nga 1 shtatori- 31 dhjetor 2012 dhe nga 1 janar- 31 mars 2013 dhe veprimet e më pastajme.

Konsumatorët shtëpiakë	Faturimi para procedurave m3/muaj	Faturimi me procedura 01.09-31.12.2012 m3/muaj	Koeficienti i ngarkesës shtesë nga 1 janari-31 mars 2013	Faturimi me procedura 01.01-31.03.2013 m3/mu	Autorizimi i kompanive për veprime legale pas 1 prilli 2013
Apartamente	30	19	1.5	29	Shkyçje
Shtëpi urbane	30	23	1.5	35	Shkyçje
Shtëpi gjysmë urbane, ose rurale	30	26	1.5	38	Shkyçje

Arsyetimi për veprime të autorizuara për veprimet e kompanisë ndaj konsumatorëve;

1. Eliminimin e faturimit paushall i cili është konsideruar si jo i drejtë.
2. Faturimi mbi baza reale të konsumit të matur të shërbimeve të ujit të marra.
3. Mbrojtjen e konsumatorëve nga faturimi i pa bazuar i shërbimeve të marra nga kompania.
4. Shtytjen e konsumatorëve për instalim të ujëmatësive dhe eliminim e plotë të faturimeve të tilla për konsumatorët ekzistues dhe ata të rinjë, që kërkojnë kyçe në rrjetin e shërbimeve të kompanive.
5. Standardizimin e faturimeve të tilla për çdo kompani veç e veç etj.

Me këtë aktivitet synojmë të mbrojmë konsumatorët nga faturimi i pa matur i ujit i cili mund të jetë në dobi ose me përfitim të njëres palë të këtyre marrëdhënieve të shërbyera.

3.3.2.5. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e mbeturinave të ngurta komunale 2012

Udhëheqja e procesit të përcaktimit të tarifave të shërbimit për grumbullim të mbeturinave të ngurta komunale dhe atë të administrimit të deponive sanitare ka filluar nga gjysma e muajt shkurt 2012 dhe është përmbyll në fund të muajt Maj të njëjtë vit, për këto tri kategori të konsumatorëve; **(i)** grumbullimin e mbeturinave të ngurta komunale të bashkësive familjare, **(ii)** grumbullimin e mbeturinave të ngurta komunale për biznese dhe industri, **(iii)** dhe ato të

institucioneve. Afati i vlefshmërisë së tarifave të këtij shërbimi ishin paraparë për periudhën kohore: 1 Qershor 2012 - 31 Maj 2013.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Mbeturinave më 08.06.2012, këto tarifa shpallen të pa vlefshme.

Pasqyra një vjeçare e tarifave për shërbim të administrimit të mbeturinave

Në tabelën e më poshtme po i ofrojmë të dhënat e tarifave të përcaktuara për kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë periudha kohore 1 Qershor 2012 – 31 Maj 2013 (kanë vlejtur vetëm deri më 08.06.2012).

Tabela nr. 13. Pasqyra e tarifave të shërbimit për grumbullim të mbeturinave të ngurta komunale dhe atë të administrimit të deponive sanitare për vitin 06/2012-05/2013 dhe ato historike 06/2010-05/2011 dhe 06/2011-05/2012 pa TVSH.

Nu. Ren.	Emërtimi i kompanive	Tarifa e shërbimit 06/2010-05/2011 €/muaj	Tarifa e shërbimit 06/2011-05/2012 €/muaj	Tarifa e shërbimit 06/2012-05/2013 €/muaj	% e tarifës së ngritur nga një vit te tjetri
1	KRM "Pastrimi" sh. a. Prishtinë	4,14	4,14	4.31	4.11
2	KRM "Çabrat" Sh. a. Gjakovë	4,31	4,48	4.48	0.00
3	KRM "Pastërtia" Sh. a. Ferizaj	4,01	4,31	4.31	0.00
4	KRM "Higjiena" Sh. a. Gjilan	3,93	4,14	4.31	4.11
5	KRM "Eko-Regjioni" Sh. a. Prizren	3,88	3,88	4.14	6.70
6	KRM "Ambienti" Sh. a. Pejë	3,45	3,45	3.62	4.93
7	KRM "Uniteti" Sh. A. Mitrovicë	3,45	3.80	3.80	0.00
	Mesatarja e tarifave për konsumatorët shtëpiakë prej 1-7	3,88	4,03	4.14	2.73
8	KMDK Sh. a. Prishtinë	5,26 €/ton	5,26 €/ton	5.31	0.95

3.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE

3.4.1. Zbatimi i standardeve të shërbimit

Për të siguruar shërbime sa më kualitative për konsumatorët, gjatë vitit 2012 ZRRUK i ka kushtuar vëmendje të posaqme përmbushjes së Standardeve Minimale të Shërbimit, të cilat janë obligative për t'u plotësuar nga ana e ofruesëve të shërbimeve me ujë dhe kanalizim.

Duke u nisur nga shqetësimet të cilat i kemi hasur si gjatë monitorimit të KRU-ve ashtu edhe nga shqetësimet e hasura në informacionet e paraqitura nga të gjitha palët e interesit (raportet e KRU-ve, raportet e IKSHPK, ankesat e konsumatorëve etj.) dhe në përputhje me 'Planin Strategjik 2012 – 2014' të ZRRUK, gjatë vitit 2012 kemi përcjellë përmbushjen e disa standardeve të shërbimit siq janë: kualiteti i ujit, leximi dhe vendosja e ujëmatësve, standardizimi i paushallit, shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve etj.

Për qëllimet e përmendura më lart janë zhvilluar aktivitetet e ndryshme si: inspektimet, takimet me të gjitha palët e interesit, masat administrative, shqyrtimi i kërkesave për lirim nga përmbushja e standardeve etj.

Në vazhdim të këtij kapitulli janë të paraqitura më detajisht standardet të cilat janë përcjellë gjatë vitit 2012, veprimet e ndërmarra nga ZRRUK dhe rezultatet e këtyre aktiviteteve.

3.4.1.1 Kualiteti i Ujit

KRU-të janë të obliguara të ofrojnë ujë i cili i përmbush Standardet e Kualitetit të Ujit të cilat janë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 2/1999.

Mbikqyrja e përmbushjes së këtyre standardeve bëhet nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK), dhe në baza mujore i raporton ZRRUK-ut.

Nga raportet mujore të IKSHPK (të cilat rregullisht përcillen në ZRRUK) gjatë vitit 2012 kemi hasur në 2 raste ku kemi vërejtur që ky standard nuk është duke u zbatuar në tërësi.

ZRRUK menjëherë pas identifikimit të problemeve ka ngritur çështjen në të gjitha institucionet përkatëse (IKSHPK, Njesinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, Komuna etj.) dhe në takimet e mbajtura me të gjitha palët e interesit ka insistuar të ndërmirren të gjitha masat, me qëllim të gjetjes së një zgjidhje sa më të shpejtë dhe më të mirë për mbrojtjen e konsumatorëve.

Në vijim janë paraqitur aktivitetet e ndërmarra nga ZRRUK lidhur me këto dy raste.

a) Mospërmbushja e standardeve të ujit të pijshëm në Komunën e Klinës

Gjatë analizimit të Raporteve të IKSHPK kemi vërejtur se Kualiteti i ujit në Klinë nuk i përmbush në shkallë të larte standardet e përcaktuara si në aspektin mikrobiologjik ashtu edhe në aspektin kimik, gjë që e bën ujin e shpërndarë në rrjet burim të rrezikut të përhershëm për shëndetin e popullsisë.

Pas takimeve të shumta të inicuar nga ZRRUK me përfaqësuesit e Komunës së Klinës, NJPM-NP, IKSHPK si dhe KRU 'Hidrodrini' janë arritur këto rezultate:

- Monitorimi dhe testimi i kualitetit të ujit bëhet në mënyrë intensive nga ana e IKSHPK,
- Është bërë sigurimi i ujit të pijshëm nga ana e KRU "Hidrodrinit" me cisterna,
- Te gjitha shpenzimet financiare janë marrë nga NJPM-NP për KRU "Hidrodrinin", për furnizim emergjent me ujë të pijshëm,
- Komuna e Klinës ka sensibilizuar qytetarët e Klinës për furnizimin e përkohshëm me ujë të pijshëm,
- KRU "Hidrodrini" ka ndërmarrë aktivitete për pastrim të kaptazhes dhe klorifikimin,
- NJPM-NP ka marrë përsiper subvencionimin e inkasimit të qytetarëve deri në nivelin e inkasimit në regionit për tre muaj,
- Janë bërë investime në fabrikën e vjetër për ndërtimin e filtrave dhe të sistemit të Klorifikimit.

ZRRUK ka përcjellë me vëmendje zbatimin e këtyre masave.

Zgjidhja afatgjate dhe e qëndrueshme e furnizimit me ujë kualitativ për qytetarët e Klinës do të sigurohet me ndërtimin e Fabrikës së re, e cila pritet të jetë funksionale së shpejti (e financuar nga Komuna e Klinës).

b) Problemet në implementimin e Udhëzimit administrativ në Zonën e shërbimit të KRU 'Prishtina'

Gjatë analizimit të raporteve të IKSHPK kemi vërejtur se numri i mostrave të marra për analiza të kualitetit të ujit në Zonën e shërbimit të KRU "Prishtina" ka pasur një rënje të dukshme në

periudhën tetor 2011- korrik 2012. Numri i mostrave të mara për analizë në këtë periudhë kohore nuk është në përputhshmëri me zbatimin e Udhëzimit administrativ 2/1999

3.4.1.2 Vendosja e ujëmatësve

Vendosja e ujëmatësve, përveq që është standard obligativ sipas kornizës ligjore të ZRRUK (në përputhje me ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve), është në të mirë si të konsumatorëve ashtu edhe të vet kompanive.

Me amandamentimin e Rregullës për Standardet Minimale të shërbimit (31 Maj 2012), KRU -ve u është dhënë një afati kohor prej 1 viti për të vendosur ujëmatësat për të gjithë Konsumatorët e amvisërisë, ndërsa për Konsumatorët Komercial -Industrial dhe ata Institucional është dhënë afat kohor prej katër muajsh.

Pas këtij vendimi të ZRRUK, kompanitë kanë filluar vendosjen e ujëmatësve, duke siguruar mjete financiare nga projekte të mbështetura nga donatorët, duke shfrytëzuar mjetet vetanake, si dhe përmes sensibilizimit të konsumatorëve duke i stimuluar që të bëjnë vendosjen e ujëmatësve.

Duke pa se edhe përkundër seriozitetit të kompanive për të përmbushur kërkesat e ZRRUK nuk ka mundur që në përgjithësi të eliminohet faturimi paushall, ZRRUK ka marrë vendim që afatin kohor për vendosje të ujëmatësve ta shtyjë deri në fund të vitit 2012.

Si rezultat i aktiviteteve të cekura, në nivel të sektorit përqindja e konsumatorëve me ujëmatës në fund të vitit në Kosovë ka arritur në **91%**, që do të thotë se vetëm **9%** e konsumatorëve faturohen në mënyrë paushalle. Sa për ilustrim po përmendim se në Shqipëri **41%** e konsumatorëve faturohen paushall.

Edhe përkundër këtyre rezultateve të mira ZRRUK në vazhdimësi do të kërkojë nga KRU-të dhe konsumatorët vendosjen e ujëmatësve, në mënyrë që deri në fund të vitit 2013 të gjithë konsumatorët të jenë të paisur me ujëmatës.

3.4.1.3 Leximi i ujëmatësve

Duke pasë parasysh se leximi i ujëmatësve është standard obligativ për KRU-të i përcaktuar edhe me ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe duke u bazuar në ankesat e shumta të konsumatorëve për mos leximin e ujëmatësve nga KRU-të, ZRRUK gjatë vitit 2012 ka ndërmarë inspektim të leximit të ujëmatësve në të gjitha zonat e shërbimit në të cilat operojnë KRU-të.

Inspektimi ka përfshi rreth 200 konsumatorë në pothuajse të gjitha Njësitë Operative të KRU-ve, dhe përveq rregullshmërisë së leximit sipas standardeve të parapara, janë inspektuar edhe detalet tjera që ndikojnë në faturim sipas konsumit (funksionaliteti i ujëmatësve, bllobat, sjellja e punëtorëve të KRU-ve në raport me konsumatorët etj.).

Të gjeturat nga inspektimi na kanë treguar se leximi i ujëmatësve në nivel sektori shprehur në përqindje bëhet në **85%** të rasteve ndërsa edhe pse konsumatorët janë të paisur me ujëmatës në **15%** të rasteve nuk faturohen sipas leximit.

Si rezultat i këtij aktiviteti për mospërmbushje të standardit për leximin e ujëmatësve, ZRRUK ka shqiptuar gjopa për KRU-të, tek të cilat janë identifikuar parregullsitë më të mëdha, sa i përket leximit të ujëmatësve.

Gjopa u është shqiptuar KRU "Prishtina", KRU "Mitrovica" dhe KRU "Hidrodrini", dhe e njëjta iu është paguar ZRRUK-ut në afatin ligjor.

3.4.1.4 Shqyrtimi i ngarkesave paushalle për Njësinë Operative Vushtrri

Duke pasë parasysh problemet e mëdha që Komuna e Vushtrrisë ka me furnizim me ujë, si dhe duke marrë parasysh shqetësimet e shprehura të konsumatorëve të kësaj Komune ndaj ngarkesave

të cilat u faturohen (të cilat kanë qenë të njëjta me Nj.O. Mitrovicë dhe Nj.O. Skenderaj) edhe përkundër faktit se orari i reduktimeve në këtë Komunë është shumë i madh, ZRRUK ka aprovuar procedurë të vecantë për Njësinë Operative Vushtrri.

Si rezultat i këtij aktiviteti të ndërmarrë 2012, ngarkesat paushalle të cilat KRU i ka aplikuar për muajin shkurt 2013 janë:

- për apartamente ngarkesat janë **4,5m3 nga 28,5m3** sa kanë qenë para vendimit.
- për shtëpi urbane ngarkesat janë **9,0m3 nga 28,5m3** sa kanë qenë para vendimit
- për shtëpi gjysemrurale ngarkesat janë **14,0m3 nga 28,5m3** sa kanë qenë para vendimit.

Këto ngarkesa do të rishqyrtohen përsëri nga ZRRUK me qëllim të ndryshimit, nëse gjendja e furnizimit me ujë përmirësohet apo përkeqësohet në këtë Njesi Operative.

3.4.1.5 Trajtimi i ankesave të Konsumatorëve

Trajtimi i ankesave të Konsumatorve në shërbimin e ofruar është një nga aspektet më të rëndësishme dhe përbën një sfidë për shërbimet ndaj konsumatorit. Përderisa nga ana tjetër manaxhimi profesional dhe i suksesshëm i çdo ankese mund të kontribuojë shumë si në kënaqësinë e konsumatorit, ashtu edhe në përmirësimin e performancës së përgjithshme të Ofruesit të Shërbimeve.

Gjatë vitit 2012 ZRRUK ka ndërmarr aktivitetin e inspektimit të qendrave të konsumatorve me ç'rast, në mënyrë specifike është përqendruar në aktivitetet e KRU, në lidhje me:

- Infrastrukturen aktuale dhe mundsitë për parashtrimin dhe zgjedhjen e ankesave të Konsumatorve,
- Praktiken aktuale për menaxhimin e ankesave të konsumatorëve, si dhe
- Nivelin e respektimit të afateve ligjore për shqyrtimin dhe zgjedhjen e ankesave.

Gjatë procesit të inspektimit kemi kontaktuar me menaxhmentin e shërbimeve ndaj konsumatorve, si dhe me personat përgjegjës të KUR të angazhuar për komunikim me Konsumatorët.

Po ashtu janë kontaktuar edhe konsumatorët të cilët kanë parashtruar ankesat e tyre, në mënyrë që të merren opinionet në lidhje me trajtimin e ankesave të tyre nga ana e Kompanisë.

Inspektimi ka përfshirë 7 KRU, përfshirë njësinë qendrore dhe Nj.Operative, më pastaj janë përgaditur Raportet e Inspektimit³, në të cilat janë nxjerrë perfundime të rëndësishme dhe janë dhënë po ashtu rekomandime, me qëllim të trajtimit dhe menaxhimit të ankesave të konsumatorëve.

ZRRUK i ka dhënë KRU-ve në afat deri me 31 Qershor 2013, për ti përmbushur të gjitha rekomandimet e dhëna në Raportet e inspektimit të qendrave të Konsumatorëve.

3.4.1.6 Kërkesat për lirim nga përmbushja e standardeve të shërbimit

Në qoftese një ofrues i shërbimeve nuk ka mundësi të përmbushë ndonjë prej standardeve të shërbimit ashtu siç janë detajizuar në Rregullen për Standardet Minimale të Shërbimit, ekziston mundësia e hyrjes në marrveshje me rregullatorin për lirim nga përmbushja.

ZRRUK u ka sugjeruar Ofruesëve të Shërbimeve të shfrytëzojnë këtë mundësi.

Në këtë drejtim KRU (Bifurkacioni, Mitrovica dhe Radoniqi), kanë bërë kërkesë për lirim nga përmbushja e standardit për vendosjen e ujëmatesave, ndërsa KRU 'Hidroregjioni Jugor', për lirim nga përmbushja e standardit 24 orë furnizim për një pjese të qyteti të Prizrenit.

³ Raportet e inspektimit të trajtimit të ankesave të Konsumatorve për të gjitha KRU, mund të gjenden në Ueb faqen e ZRRUK, (www.wwro-ks.org)

ZRRUK ka shqyrtuar kërkesat dhe për KRU (Mitrovica, Bifurkacioni dhe Radoniqi) është refuzuar për të hyrë në marrëveshje, për shkak se këto kompani nuk i kanë ofruar fakte bindëse.

Kërkesa e parashtruar nga KRU 'Hidroregjionin Jugor', është duke vazhduar me negocimin e hyrjes në marrëveshje.

3.4.1.7 Aktivitetet tjera

Në vazhdim të aktiviteteve për zbatimin e standardeve dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga KRU-të, gjatë vitit 2012 ZRRUK ka kërkuar nga kompanitë të përpilojnë dhe dorëzojnë planet dinamike për disa aktivitete të cilat janë planifikuar të inspektohen nga ZRRUK gjatë vitit 2013.

Si rezultat, nga shumica e KRU-ve kemi pranuar:

- Planet dinamike të reduktimit të ujit.
- Planet dinamike për pastrimin e sistemit të kanalizimit.

Gjatë vitit 2013 ZRRUK ka paraparë monitorimin dhe inspektimin e zbatimit të këtyre planeve.

3.4.2. Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK)

Në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve konform nenit 17 të Ligjit L-086, si dhe konform Nenit 7 pika 7.1 të Rregullës për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë (ZRRUM-R-08/U&M), është paraparë Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK), si dhe janë përcaktuar modalitetet dhe funksionimi i këtyre Komisioneve.

Në kuadër të ZRRUK, këto komisione janë të themeluara dhe funksionojnë në 7 Regjionet e Kosovës, ku secila komunë brenda Regjionit të përcaktuar e ka 1 (një) përfaqësues në KKK.

Anëtarët e këtyre komisioneve janë zgjedhur sipas propozimeve nga Kryetarët e Komunave (pas intervistave dhe konsultimeve të ndryshme).

Në KKK janë të përfaqësuar të gjitha komunat të cilat i janë nënshtruar procesit të konsolidimit dhe të rajonalizimit, përfshirë edhe komunat të cilat me vendime të një anshme janë larguar nga Kompanitë Rajonale.

3.4.2.1 Aktivitetet e KKK

Në këtë kapitull është dhënë në formë të përmbledhur një pasqyrë e aktiviteteve të KKK gjatë vitit 2012.

- Gjatë periudhës Raportuese janë mbajtur 70 takime të rregullta të KKK, ku përveq shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve janë trajtuar dhe diskutuar edhe çështje tjera të rëndësishme, siq janë njoftimet dhe informimet e KKK nga ana e përfaqësuesëve të ZRRUK lidhur me:
 - Shqyrtimi i situatës lidhur me furnizimin me ujë të konsumatorëve,
 - Informimi i KKK lidhur me zbatimin e Rregullës për Standardet Minimale të Shërbimit,
 - Informimi i KKK lidhur me zbatimin e Rregullës për Kartën e Konsumatorëve,
 - Shqyrtimi i Draft Propozimit të Rregullës për përcaktimin e Tarifave të Ujit,
 - Informimi i KKK lidhur me procesin e Licencimit të Kompanive të Ujit,
 - Shqyrtimi i çështjeve tjera të cilat janë në interes të konsumatorëve.
- Nga KRU-të është kërkuar të bëhet vendosja e kutive për ankesa në vend të dukshëm në objektet e tyre, ku konsumatorët e pakënaqur me përgjigjen e marrë nga kompania, mund ti drejtojnë ankesat në KKK-të për Regjionin përkatës.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në këtë drejtim, në marrëveshje me Ofruesit e Shërbimeve të ujit është vendosur që çelësat e kutive tu epën Kryesuesve të KKK, të cilët para çdo takimi i tërheqin ankesat e vendosura në kuti.

- Në vitin 2012 ZRRUK ka vazhduar të bashkëpunoi ngushtë dhe të konsultohet me kompanitë e ujësjellësit, si dhe me palët tjera të interesit me çështjet të cilat kanë të bëjnë me punën e KKK, lidhur me mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Në këtë drejtim është zhvilluar një bashkëpunim i ngushtë me OJÇ “Konsumatori”, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Institutin IPA, si dhe me Entin Rregullator të Ujit të Shqipërisë (ERRU), lidhur me shkëmbimin e përvojave, dhe përsosjes së bashkëpunimit në këtë drejtim.
- Nga ana e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE), Instituti IPA nga data 01-04 prill 2012 për Kryesuesit e KKK dhe disa zyrtarëve të stafit të ZRRUK, ka organizuar një vizitë studimore në Angli. Fokusi i kësaj vizite ka qenë njohja me rolin dhe mënyrën e funksionimit të KKK (përvojat dhe praktikët e tyre lidhur me procedurat për parashtrimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, si dhe përfaqësimin e interesave të konsumatorëve), raportet me OFWAT nga Birmingham si Rregullator i kompanive të ujit.
- Me qëllim të avancimit dhe njohjes me ecuritë bashkëkohore lidhur me komunikimin me konsumatorë dhe zgjidhjen e ankesave, ZRRUK, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Industrisë si dhe me OJQ relevante në muajin maj ka organizuar punëtori-workshop me temë ‘Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve’. Po ashtu në vazhden e bashkëpunimit me ftesën e Entin Rregullativ të Ujit nga Shqipëria, në muajin qershor është mbajtur punëtorja me temën ‘Kodi i Punës së ZRRUK’. Kryesuesi i KKK nga Regjioni i Prizrenit në muajin nëntor 2012 në Shqipëri ka patur prezantim me temë “Kostot operative të ujit nga aspekti i KKK në Kosovë”.

3.4.2.2 Shqyrtimi i ankesave

Në vijim është dhënë në formë tabelore, numri dhe struktura e ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga KKK-të regjionale në vitin 2012.

Tabela nr.14. Numri i Ankesave të Parashtruara KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	9	4	6	2	-	6	-	5	2	2	6	11	53
KKK Mitrovicë	-	-	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	2
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
KKK Gjakovë	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Prizren	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Ferizaj	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Gjilan	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
Gjithsejtë	10	4	6	4	1	7	-	7	2	2	6	11	60

Tabela nr. 15. Numri i Ankesave të zgjedhura nga KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	-	1	-	-	2	-	-	2	-	-	8	9	22
KKK Mitrovicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Gjakovë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KKK Prizren	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1
KKK Ferizaj	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	1
KKK Gjiilan	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1	-	-	2
Gjithsejtë	-	1	1	1	2	1	-	2	-	1	8	9	26

Shënim:

11 - Ankesa iu janë dërguar Kompanive në RISHQYRTIM

7 - Ankesa iu janë kthyer palëve për plotësim lënde.

16 - Ankesa në bashkëveprim me Kompanitë dhe konsumatorët janë zgjedhur.

Nga analizat më të hollësishme të ankesave si përfundim kemi:

- KKK në regjionin e Prishtinës i kanë arritur me shumë ankesa (53 ankesa), KKK të Mitrovicës (2 ankesa) ndërsa KKK të regjioneve tjera kanë pasur vetëm nga 1 ankesë.
- Natyra e ankesave kryesisht është për shkak të Zbritjes/Shlyerjes së Borxhit (35 ankesa), faturimit paushall (23 ankesa) por edhe për lartësinë e tarifave (2 ankesa).
- Numri më i madh i ankesave kanë arritur nga Konsumatorët Shtëpiak (54 ankesa), përderisa vetëm 6 ankesa janë nga kategoria e konsumatorëve jo shtëpiak.

4. Aktivitetet në Konsolidimin Institucional

4.2. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV

Në pajtim me Planin Strategjik 2012-2014 të ZRRUK, dhe Planin e Punës të ZRRUK janë ndërmarrë këto aktivitete:

4.2.1. Amandamenti i Ligjit Nr.03/ L-086 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi Veprimtaritë e Ofruesëve të Shërbimit të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave ("Ligji Nr. 03/L-086")

Në lidhje me këtë aktivitet ZRRUK gjatë muajit shtator ka themeluar Komisionin për një propozim të Amandamentit të Ligjit Nr.03/L-086, në marrëveshje me Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të detyrave të dhëna Komisioni pas takimeve të shumta, analizave dhe shqyrtimit të propozimeve, ka përpiluar Propozim-Draftin (Projekt Ligjin) për Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjellësit, Ujërave të Ndotura dhe Furnizuesve të ujit me shumicë.

Ky Draft (Projekt Ligj) i është dorëzuar Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor (KBPMF) të Kuvendit të Republikës së Kosovës me datën 29.11.2012 për punë të mëtejme.

Me datën 11.12.2012 Komisioni Parlamentar ka miratuar nismën për hartimin e Projektligjit për ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesve të ujit me shumicë sipas nenit 53 dhe 54 të Rregullorës së Kuvendit të Kosovës.

4.2.2. Amandamenti i legjislacionit sekondar;

Gjatë vitit 2012 është Amendamentuar Rregulla për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë ("R02/U&K").

Në pajtim me Planin strategjik dhe Planin e Punës, Amendamenti i legjislacionit sekondar është aktivitet në vazhdimësi edhe në vitin 2013.

4.2.3. Amandamenti i Licencave të shërbimit

Gjatë vitit 2012 ZRRUK ka amendamentuar 2 Licenca të Shërbimit për shkak të Vendimeve të njëanshme dhe kundër ligjore nga asamblatë Komunale Deqan dhe Kaçanik, për derajonalizim nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit. Licencat e amendamentuara janë:

- Licenca e Shërbimit të KRU "Hidrodrini" - prej së cilës është larguar **Komuna e Deqanit** nga Zona e shërbimit të KRU "Hidrodrini" dhe
- Licenca e Shërbimit të KRU "Bifurkacioni" – prej së cilës është larguar **Komuna e Kaçanikut** nga Zona e shërbimit të KRU "Bifurkacioni"

Ky vendim mbetet në fuqi deri në një përgjigje nga MZHE, në pajtim me nenin 6 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

4.2.4. Komisioni Shqyrtues

Në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 03/L-086 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave, Komisioni shqyrtues ka mandat për shqyrtimin e ankesave nga ofruesit e shërbimeve ndaj çdo Vendimi të sjellë nga Rregullatori në pajtim me nenin 33, me kusht që të jenë respektuar afatet e parapara Ligjore.

Komision shqyrtues përbëhet nga ***kryesuesi i emëruar nga Kuvendi***, një anëtar i emëruar nga Rregullatori dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve i cili ka parashtruar kërkesë për shqyrtim.

Komisioni shqyrtues miraton procedurën e cila zbatohet gjatë marrjes parasysh të çështjeve të referuara për Komisionin shqyrtues.

Në vitin 2012, Komisioni Shqyrtues ka shqyrtuar ***dy ankesa*** të ofruesve të shërbimit kundër vendimeve të ZRRUK-ut:

1. Ankesën e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit, “Radoniqi”, Sh. A, Gjakovë (më tutje: KRU, “Radoniqi”), e bërë me datë: 09. 10. 2012, me Nr 499, ndaj vendimit të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (më tutje: ZRRUK), që i referohet llogaritjes së paushallit për konsumtarët pa ujëmatës, datë 27. 08. 2012.

Komisioni Shqyrtues, pas prezantimeve dhe sqarimeve të cilat janë bërë nga përfaqësuesi i ZRRUK, ku janë shqyrtuar të gjitha rrethanat e vendimit të ZRRUK-ut për aprovimin e procedurave interne për aplikim nga KRU, “Radoniqi”, për faturim të konsumatorëve pa ujëmatës ose me ujëmatës jo funksional, përmes përfaqësuesit të saj në Komisionin Shqyrtues ***KRU “Radoniqi”, është tërhequr nga ankesa*** duke pranuar kështu vendimin e ZRRUK-ut, me arsyetimin se nuk e kuptuar mirë vendimin e ZRRUK-ut.

1. Ankesën e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit, “Hidrodrini” Sh. A. Pejë (më tutje: KRU, “Hidrodrini”) e bërë me datë: 05. 12. 2012, me Nr 535 ndaj vendimit të ZRRUK-ut, datë: 22. 11. 2012, me Nr 509 për gjobitjen e KRU “Hidrodrini” me të holla në shumën prej 1.100.00 (njëmijënjëqind) Euro.

Vendimi i ZRRUK-ut për gjobitjen e KRU, “Hidrodrini” është bazuar në faktin se nuk është respektuar Standardi i Shërbimit- Leximi i Ujëmatësve.

Vendimi për gjobitje është bazuar në raportin e Inspektimit “*Inspektimi i Leximit të Ujëmatësve për KRU ‘Hidrodrini’*”. Raporti ka qenë rezultat i inspektimit i cili është krye nga ZRRUK në bashkëpunim me KRU “Hidrodrini” me datë.17 dhe 18. 09. 2012.

Për këto arsye Komisioni Shqyrtues ka vendosur që të ***mbetet në fuqi vendimi i ZRRUK-ut*** Nr 509 i datës: 22. 11. 2012 për gjobitje.

4.2.5. Inicimi i Procedurave Gjyqësore

ZRRUK ka iniciuar procedura gjyqësore ndaj Ofruesve të Shërbimit të cilët nuk i janë përmbajtur obligimeve të parapara me legjislacion primar dhe sekundar.

Konkretisht ZRRUK ka proceduar Propozim për Përmbarim ndaj Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin dhe Deponimin e Mbeturinave pranë Gjykatës Ekonomike në Prishtinë.

Janë proceduar gjithsej 8 (tetë) Propozime për Përmbarim, aktivitet ky i cili nuk ka përfunduar gjatë vitit 2012 dhe është në vazhdimësi.

4.2.6. Shqyrtimi i Kërkesave për Shkyçje Kolektive

ZRRUK shqyrton kërkesat e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit për shkyçje kolektive në pajtim me Ligjin, Rregullat dhe procedurat e brendshme të ZRRUK.

Tabela nr.16. Shkyçjet Kolektive gjatë vitit 2012

Nr. rend	KRU	Nr. i aplikacionit	Shqyrtuar	Vërejtje
01	"Radoniqi" Sh.A.Gjakovë	3270	Nuk aprovohet	
02	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	401	Aprovohet	
03	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	557	Nuk aprovohet	
04	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	871	Aprovohet	
05	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	869	Nuk aprovohet	
06	"Prishtina" Sh.A.Prishtinë	1657	Aprovohet	

Gjithsejtë janë parashtruar 6 aplikacione për Shkyçje; 3 (tri) janë aprovuar, 3 (tri) nuk janë aprovuar.

4.2.7. Mbështetja Institucionale nga Donatorët

ZRRUK ka ndërtuar raporte të shkëlqyeshme të bashkëpunimit me të gjitha institucionet donatore në Kosovë.

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) e ka mbështetur aplikacionin e ZRRUK të bërë në vitin 2009, për mbështetje institucionale të ZRRUK gjatë viteve 2010- 2012.

Projekti ka filluar me 31 Maj 2010. Financuar nga BE, menaxhuar nga ZNKE, dhe implementuar nga konzorciumi IPA-as.

Gjatë 2012, Projekti mbështetës për ZRRUK, i financuar nga KE dhe menaxhuar nga ZNKE, në bashkëpunim me ZRRUK ka realizuar aktivitetet në vijim:

1. Baza e të Dhënave,
2. Kontabiliteti Rregullator,
3. Plani i Menaxhimit të aseteve,
4. Strategjia e Komunikimit,
5. Raporti Final i projektit,
6. Ofrimi i mbështetjes Ad hoc për ZRRUK në lidhje me çështje të ndryshme sipas kërkesës së Drejtorit të ZRRUK.

Projekti zyrtarisht ka përfunduar mandatin më 30 maj 2012.

5. Relacionet e Jashtme

5.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË

Në pajtim me orientimet strategjike të ZRRUK për bashkëpunim të hapur dhe të mirëfilltë me të gjitha palët e interesit të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë, e me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për arritjen e përmirësimeve të nevojshme në këta sektorë, ZRRUK edhe në vitin 2012 ka vazhduar qasjen e tij të hapur dhe bashkëpunuese me rregullatorët tjerë të këtyre sektorëve, si dhe me palët tjera të interesit.

(i) Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, ZRRUK ka vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në fushën e monitorimit të standardeve të kualitetit të ujit të pijes që ofrojnë kompanitë publike të licencuara.

Përpos takimit të rregullt vjetor që kemi pasur në muajin shkurt, bashkëpunimi ka konsistuar në shkëmbimin e rregullt të informacioneve me interes të dy palëve. Në këtë plan, në Raportin Vjetor të Performancës 2011 për kompanitë e ujësjellësit, ZRRUK ka shfrytëzuar të dhënat e IKSHPK.

(ii) Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Duke pasur parasysh rolin e MMPH si autoritet kryesor për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë dhe si rregullator mjedisor i sektorit të ujit dhe mbeturinave, ZRRUK edhe gjatë vitit 2012 ka vazhduar bashkëpunimin me MMPH në sektorët e ujit dhe mbeturinave.

ZRRUK ka pasur disa takime me përfaqësuesit e MMPH në të cilat janë diskutuar problemet aktuale në sektorin e ujërave dhe në veçanti atë të mbeturinave dhe me këtë rast janë diskutuar edhe çështjet që lidhen me harmonizimin e legjislacionit në këta sektorë me qëllim të përcaktimit të qartë të rolit dhe përgjegjësiwe institucionale në sektorin e ujit dhe mbeturinave.

(ii) Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim (NJPM) të MEF

Pas marrjes së përgjegjësiwe nga MZHE, respektivisht nga Njësia për Politika dhe Monitorim (NJPM) në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ZRRUK ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e ndërmarrjeve publike qendrore.

Gjatë vitit 2012, kemi zhvilluar shumë takime të përbashkëta, duke përfshirë edhe punëtori, sidomos rrethë rastit të ujit të pijshëm në Klinë.

(iii) Bashkëpunimi me Palët tjera

Në vitin 2012, ZRRUK ka bashkëpunuar edhe me palët tjera të interesit, në kuadër të domenit të përgjegjësiwe të veta. Vlen të përmendet këtu bashkëpunimi me:

- Ministrinë për Integritet Evropian (MIE) në lidhje me hartimin e Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), si dhe raportim për Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit (DPSA), në Bruksel.
- Takim me Ministrin e MZHE, rreth implementimit të Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 06/18.

- Bashkëpunimi me Task Forcën e Ujit (TFU) në lidhje me Adresimin e krijimit të Politikave për Subvencionimin e Rasteve Sociale etj.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH), në aspektet e resurseve ujore, Amandamentimin e Ligjit të Mbeturinave.
- Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM).
- Asociacionin e Komunave të Kosovës, dhe me
- Përfaqësuesit e donatorëve (ZNKE, USAID, KFË, SCO, GTZ etj.) dhe konsulentëve që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave dhe mbeturinave në Kosovë.

Me të gjitha këto palë, qoftë në takime të drejtpërdrejta apo në punëtori dhe konferenca, janë diskutuar zhvillimet në sektorët e ujit dhe mbeturinave dhe është paraqitur qëndrimi i ZRRUK lidhur me problemet aktuale në këta sektorë.

5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EVROPË

Bashkëpunimin me rregullatorët tjerë të sektorit të ujërave, ZRRUK e konsideron me rëndësi vitale, për shkëmbimin e përvojave dhe për adoptimin e praktikave të mira në fushën e zbatimit të rregullimit ekonomik të shërbimeve të ujit.

- Në këtë plan, në vitin 2012 ZRRUK ka vazhduar të bashkëpunojë me rregullatorin ekonomik të shërbimeve të ujit të Shqipërisë (ERRU), bashkëpunim ky i iniciuar më herët, e që është formalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi në vitin 2009. Kemi pasur një vizitë pune, dhe shkëmbim të stafit, gjatë tërë vitit 2012.
- Në anën tjetër, bashkëpunimi me rregullatorin e shërbimeve të ujit të Portugalisë i iniciuar në fund të vitit 2007, ka vazhduar me shkëmbimin e informacioneve si dhe me shkëmbimin e Raportit Vjetor të Performancës 2011 të Kosovës.
- Në vitin 2012 kemi pasur një takim të përbashkët me Kryetarët e Rregullatorit të Shqipërisë dhe Portugalisë, në Shqipëri, ku është diskutuar për përvojat dhe sfidat e Rregullatorëve në rajon.
- Me ftesën e Entit Rregullator të Ujit (ERRU) të Shqipërisë, Zyrtarët nga Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK), gjegjësisht Drejtori dhe Kryesuesi DMP, kanë qëndruar në Shqipëri (Tiranë) nga data 08 deri me 10 Tetor 2012, për të marrë pjesë në ceremoninë e organizuar nga ERRU, me rastin e Publikimit të Raportit të parë të performancës për shoqëritë e Ujësjellës-Kanalizimeve të Shqipërisë. S' bashku me ne në këtë vizitë kanë qenë edhe tre (3) Deputet të Parlamentit të Kosovës, gjegjësisht të Komisionit Parlamentar për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, të udhëhequr nga Kryetari i Komisionit me q' rast janë njoftuar më për së afërmi me përgjegjësit dhe aktivitetet e ERRU të Shqipërisë.

5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN

ZRRUK në vitin 2012 është angazhuar që përmes formave të ndryshme të ndikojë në njoftimin e institucioneve dhe publikut të gjerë, për atë se çfarë është roli dhe funksioni i rregullativës ekonomike që e zbaton ZRRUK.

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2012 i është kushtuar informimit të publikut lidhur me Standardet Minimale të shërbimeve me ujë dhe kanalizim – **ZRRUK ka publikuar broshurën** e cila iu është shpërndarë konsumatorëve.

Me qëllim të informimit të konsumatorëve dhe sensibilizimin e opinionit publik për rolin e KKK-ve, ZRRUK është angazhuar që të promovohet roli i tyre përmes mjeteve të informimit. Përmes gazetave ditore ZRRUK ka bërë publik Orarin e takimeve mujore të KKK në mënyrë që palët e interesuara të mund të marrin pjesë në këto takime.

Po ashtu gjatë muajit Nëntor-Dhjetor 2012 në RTK është transmetuar kampanja për njoftimin e qytetarëve lidhur me rolin e ZRRUK dhe KKK, si dhe thirrjen e qytetarëve për vendosjen e ujëmatësve.

Gjithashtu janë lëshuar edhe komunikata me shkrim, kryesisht rreth përcaktimit të tarifave

ZRRUK përmes ueb.faqes www.wwro-ks.org iu ka mundësuar konsumatorëve që të informohen detalisht lidhur me aktivitetet të cilat po i zhvillon ZRRUK .

Për të krijuar një pasqyre sa ma reale lidhur me nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit, ZRRUK gjatë muajit Tetor-Nëntor ka realizuar projektin ***"Hulumtimin e opinionit të konsumatorëve për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë"***. Ky hulumtim është me rëndësi të veçantë për ZRRUK ,konsumatorët dhe Kompanit sepse përmes të këtyre të dhënave që dalin nga ky hulumtim,nxirët një pasqyrë e qartë lidhur me opinionet e konsumatorëve ndaj shërbimeve të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit që Licencohen dhe monitorohen nga ZRRUK .

Ky hulumtim është publikuar në faqën zyrtare të ZRRUK.

6. Aspektet Financiare

Edhe pse ZRRUK lidhur me aspektet financiare i raporton Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa, si dhe Komisionit për Mbikëqyrje Financiare në Kuvendin e Kosovës, e shef të arsyeshme që edhe për aspektet financiare shkurtimisht të e njoftoj Komisionin për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor.

ZRRUK në vitin fiskal 2012 ka arritur një marveshje me Njësën Harmonizuese të Thesarit lidhur me auditimin e brendshëm si përkrahje për ZRRUK-un i cili ka audituar ZRRUK-un. Po ashtu pasqyrat financiare të ZRRUK-ut për vitin 2012 janë audituar edhe nga Auditori i Përgjithshëm ku opinioni i tyre ka qenë shumë pozitiv.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-086 (neni 8.4), si burim kryesor për financimin e aktiviteteve të ZRRUK janë taksat e licencimit që i paguajnë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe Kanalizimit. Lartësia e taksave të licencimit caktohet në bazë vjetore sipas kriterëve vijuese:

- Të hyrat nga këto taksa korrespondojnë me shpenzimet e planifikuara të ZRRUK për vitin aktual, me kusht që:
- Lartësia e taksës mos të tejkalojë 1.5% të qarkullimit bruto vjetor të ofruesve të shërbimeve.
- Lartësia e Taksës vjetore të Licencimit për vitin 2012 ka qenë 0.90%.

Buxheti vjetor i ZRRUK aprovohet nga Kuvendi i Kosovës. Me rastin e planifikimit të shpenzimeve vjetore ZRRUK udhëhiqet nga parimet e operimit eficient financiar me qëllim që rregullimi ekonomik i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të mos ketë kosto të lartë për konsumatorët, ku kostoja vjetore e Taksës Vjetore të Licencimit për vitin 2012 për një konsumator ka qenë 0.82 cent.

6.1. SHPENZIMET

ZRRUK të gjitha transaksionet financiare i kryen përmes barazimeve mujore të sistemit të Thesarit dhe mban kontabilitetin e vet financiar dhe material.

Për vitin fiskal 2012, ZRRUK ka pasur në dispozicion mjete financiare në lartësi 327,619.00 EUR.

Në tabelën më poshtë është dhënë një pasqyrë e burimeve financiare që ka pasur në dispozicion ZRRUK në vitin fiskal 2012, si dhe shpenzimeve të realizuara.

Tabela nr. 17: Buxheti i ZRRUK për 2012

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	163,450.00	161,376.00
Mallra dhe shërbime	157,519.00	151,021.99
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	6,650.00	5,626.01
Total Buxheti	327,619.00	318,024.00

ZRRUK buxhetin e vitit 2012 e ka shpenzuar në 97,07%.

6.2. MBËSHETETJA NGA DONATORËT

Duhet të theksohet se përpos këtyre mjeteve, ZRRUK në vitin 2012 ka pasur mbështetje institucionale nga donatorët në formën e asistencës teknike e cila ka përfunduar në muajin maj 2012. (Ka filluar prej datës 16 korrik 2010 e deri në maj 2012 në vlerë prej 1.8 mil.€ në total), të cilat janë menaxhuar nga vet donatorët.

6.3. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2012

ZRRUK për vitin 2012 ka planifikuar të inkasoj 332,757.59 Eur. nga kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, prej të cilave ka inkasuar 225,309.06 Eur. apo në % ka inkasuar 67,70% prej të hyrave të planifikuara.

Me rastin e ndryshimit të Ligjit për Mbeturinat Nr. 04/L 060 neni 82 dhe 83 e ligjit, ZRRUK nuk është më kompetent për rregullimin e sektorit të mbeturinave.

Tani ZRRUK është përgjegjës për rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit që përfshihen edhe ujërat e zeza në përgjithësi.

Emërtimi i Rregullatorit deri në amendamentimin e Ligjit 03/086 do të jetë **Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK), në pajtim me MAP-in.**

Me rastin e ndryshimit të Ligjit për Mbeturina kompetencat e ZRRUK-it në sektorin e mbeturinave janë bartur te Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, **dhe që nga një korriku 2012 ZRRUK nuk iu ka faturuar taksën e licencimit këtyre kompanive që merren me grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave.**

Vlen të theksohet se ZRRUK për vitin 2012 nga kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit ka inkasuar **100%** të taksës së licencimit të planifikuar për vitin 2012, ndërsa te kompanitë e licencuara për grumbullimin e mbeturinave janë faturuar 55,568.58€ ndërsa janë inkasuar 3,900.21€ apo në % 7.01%.

Arsyeja e mos inkasimit të taksës së licencimit nga Kompanitë për Grumbullimin e Mbeturinave të licencuara nga ZRRUK ka qenë ndryshimi i Ligjit 04/L060 neni 82 dhe 83 si dhe gjendja e shume e dobët financiare e këtyre kompanive.

Borxhlinjtë e ZRRUK-it për vitin 2012

Borxhlinjtë e ZRRUK-it për vitin 2012 janë të gjitha kompanitë e licencuara që ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në vlerë prej 51,667.96€.

ZRRUK për inkasimin e borxheve edhe të viteve të më parshme dhe të vitit 2012 **ka iniciuar procedurat gjyqësore** për inkasimin e këtyre mjeteve.

6.4. ASETET E ZRRUK

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, pastaj Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetë e bëjnë regjistrimin e aseteve, ndërsa amortizimin e tyre mbi vlerën 1000€ e bën departamenti i Thesarit.

Vlera e aseteve të përgjithshme pas regjistrimit dhe vlerësimit në ZRRUK është 55,274.15€

7. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Qasja në shërbime të ujit dhe kanalizimit është e drejtë e çdo qytetari, prandaj të gjitha Institucionet përgjegjëse për këtë sektor, në përputhje me përgjegjësitë institucionale dhe ligjore që kanë duhet të angazhohen maksimalisht në avancimin e këtij sektori.

Bazuar në të dhënat, informacionet dhe analizat të cilat u prezantuan në këtë Raport për përmirësimin e ofrimeve të shërbimeve rekomandojmë:

➤ **Në aspektin Legjislativ (Ligjor):**

- Qeveria të ndërmerr masat e duhura për Integrimin e Kompanive lokale në kuadër të Kompanive rajonale (në përputhje me Planin e Konsolidimit të ujit dhe Vendimit të Kryeministrit për integrimin e Njësive Operative në kuadër të KRU-ve)
- Qeveria të ndikojë në integrimi i sistemeve rurale në kuadër të Kompanive Rajonale (sistemet të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të)
- IKSHPK të imponojë zbatueshmërinë në tërësi të Udhëzimit administrativ Nr.16/2012 për përmbushjen e standardeve të kualitetit të ujit të distribuuar nga KRU-të
- ZRRUK të vazhdojë dhe të intensifikojë monitorimin e përmbushjes së standardeve të shërbimit nga ofruesit e shërbimeve dhe të përdorë të gjitha mekanizmat për nxitjen e KRU-ve në arritjen e objektivave të përcaktuara përmes procesit tarifar

➤ **Në aspektin Financiar:**

- Qeveria, KRU-të dhe Komunitat të ndërmarrin investime të nevojshme për ngritjen e kapaciteteve të prodhimit të ujit, zhvillimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe zhvillimin e burimeve të reja të ujit
- Qeveria të sigurojë subvencionimin e faturave për shërbimet e ujit për konsumatorët të cilët janë në gjendje të rëndë sociale.

➤ **Në aspektin Administrativ:**

- Bordet e Drejtorëve të insistojnë në përmirësimin e performancës nga KRU-të.
- KRU-të të ngritin nivelin e stafit të kualifikuar – sidomos në pozitat menaxhues.
- KRU-të përpilojnë “Planet strategjike” duke u bazuar në “Planin e Përgjithshëm” (hartuar nga ZRRUK dhe projekti i IPA-s) për reduktimin e ujit të pa faturuar.
- KRU- të të hartojnë strategji dhe plane për të ngritur nivelin e arkëtimit dhe faturimit.
- KRU-të të ngrisin nivelin e faturimit sipas leximit të ujit të konsumuar (leximi i ujëmatësve).
- KRU-të të sigurojnë menaxhim më të përgjegjshëm dhe më efikas të ankesave të konsumatorëve duke respektuar afatet që dalin nga obligimet ligjore nga Standardet Minimale të Shërbimit.
- ZRRUK të mbështesë KRU-të në zbatimin e të gjitha aktiviteteve të cilat kanë qëllim përmbushjen e Standardeve Minimale të Shërbimit.

- ZRRUK të vazhdojë promovimin e interesave të konsumatorëve përmes adresimit të çështjeve, të pa zgjidhura në mes të konsumatorëve dhe ofruesve të këtyre shërbimeve.
- Komunitet të mbështesin Qeverinë lidhur me çështjet pronësore në aspektin e integritetit të sistemeve rurale.

Besojmë se me aprovimin e rekomandimeve të lartë përmendura nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor (KBPMF) të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe me zbatimin e tyre në të ardhmen nga të gjitha palët do të ngritet niveli i shërbimeve me ujë dhe kanalizim.

Adresa e ZRRUK**Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim**

Rruga: Ferat Dragaj, 68

Prishtinë 10000 Kosovë

Tel: +381 (0) 38 249 165

Web: www.wwro-ks.org

Sekretaria:

Tel: 38 249 165 lok. 101

Email: lule.aliu@wwro-ks.org

Zyrtari për mbrojtjen e konsumatorëve:

Tel: +381 (0) 38 249 165 lok. 113

Email: syle.syla@wwro-ks.org